

# SHOQËRIA CIVILE

(Ngritja dhe zhvillimi në periudhën profetike)

D-r. Abdulaziz ibën Ibrahim El-Umerij

“Atyre nga mesi juaj të cilët besuan dhe bënë vepra të mira, All-llahu u premtoi se do t’i bëjë zotërues në atë tokë ashtu si i pat bërë zotërues ata që ishin para tyre dhe fenë të cilën Ai e pëlqeu për ta, do ta forcojë, e në vend të frikës Ai do t’ju dhurojë siguri. Ata më adhurojnë Mua e nuk më shoqërojnë asgjë. E kush edhe pas kësaj mohon, të tillët janë ata më të prishurit.” Nur:55

## Parathënie

I gjithë falënderimi i takon Allahut, lavdia dhe paqja qofshin për të Dërguarin e Allahut, familjen, shokët dhe miqt e tij, sakaq:

Kam shkruar e lexuar shumë rreth Jetëshkrimit Profetik dhe nga gjërat kryesore që kam hasur aty është kujdesi ndaj njeriut, jetës së tij shoqërore përfshirë organizimin e saj si dhe ngritjen e drejtësisë e barabarësisë. E si mund të mos jetë kështu kur i Madhërishmi tha: “E Ne të dërguam ty (Muhammed) vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat.” (Enbija:107) Kjo mëshirë nënkuptonte jetën e rehatshme, lehtësimin e faktorëve të saj duke ia shtuar edhe lumturinë e botës tjetër.

Këtë e gjeta të shpërndarë në sunetin dhe Jetëshkrimin Profetik dhe shkrova për këtë temë në librin tim mbi jetën e profetit “I Dërguari i Allahut dhe vula e profetëve” ashtu siç e kam trajtuar edhe në simpoziume të ndryshme shkencore dhe më pas e pashë të rrugës që këtë temë të nxjerrja si një studim më vete me titull “Shoqëria civile, ngritja dhe zhvillimi në Jetëshkrimin Profetik” për ta bërë këtë temë të kapshme për lexuesit bashkëkohor me kulturë të përgjithshme e të shohin se i Dërguari para të gjithëve ka organizuar jetën qytetare e shoqërore dhe ka realizuar botëkuptimin e jetës me liri, fisnikëri, drejtësi për muslimanët dhe jomuslimanët të cilët dëshirojnë të jetojnë në paqe dhe të integruar në shoqëritë ku zbatohen të drejtat. Lusim Allahun të na kthejë tek Ai në mënyrën më të bukur, të na udhëzojë në çështjet tona dhe të ngritë umetin e Muhamedit, lavdia dhe paqja qofshin mbi të!

\*\*\*

## Hyrje

Ka disa definicione të ndryshme lidhur me konceptin 'shoqëri civile'. Kuptimi themelor është 'shoqëria ku sundon ligji nën pushtetin e shtetit'

Njeriu i kushton rëndësi mënyrës së jetesës, njëjtë sikur edhe shumë individë të shoqërisë si dhe tregojnë gatishmëri për ta organizuar atë dhe të kontribuojnë për të mirën e saj.

'Civile' (qytetare) i përshkruhet qytetit (medine) nga ku rrejdh edhe fjala 'medenijeh' apo 'temeddun' që nënkupton realizimin e shkaqeve të qytetwritit që i tubon njerëzit në një sistem dhe përgjegjësi.

Qysh me paraqitjen e Profetit ishte i qartë angazhimi i tij për të përhapur nënshtrimin ndaj Zotit dhe besimin në monoteizëm. Qw në vitet e para të thirrjes në Mekë, ai përgëzonte shokët e tij për përhapjen e Islamit në çdo vend dhe triumfin e tij mbi sistemet tjera të ndryshme. Meka dhe periferia e saj në të cilën filloi mesazhi islam, funksiononte në bazë të dokeve dhe zakoneve shumica e të cilave ishin të padrejta. Nuk kishte ligjëvënie të caktuar, as sistem të konsoliduar as gjyqësor të drejtë.

Islami erdh duke mbrojtur të drejtën e Allahut dhe të drejtat e robërve të Tij përfshirë mëshirën, drejtësinë, barabarsinë dhe pesë synimet madhore – siç i ka përmendur Gazaliu në 'Mustesfa', Shatibiu në 'Muvafekat'- mes njerëzve, mirëbërjen në çdo lëmi, me një politikë të brendshme dhe të jashtme që ruante faktorët e çdo shoqërie të qytetëruar.

Pasi që e veshtirë për Profetin për të shndërruar Mekën në shtet dhe shoqëri islame, ai nisi të kërkojë vende apo fise të tjera që do e ndihmonin me një vend të përshtatshëm dhe një popull mbështetës të shtetit islam në të cilin do jetonin muslimanët në një shoqëri, humane, islame, paqësore dhe solidare e cila do t'ua kalonte shoqërive tjera, me faktin që do lidhej me Allahun dhe ligjin e Tij për të çuar atë drejt lumturisë dhe përsosurisë si dhe për të qenë e drejtë ndaj vetvetes

dhe ithtarëve të feve tjera të cilët kërkonin jetë të ndershme. Profeti nisi t'ua bëjë këtë ofertë fiseve gjatë sezonëve arabe duke kërkuar kështu ndihmëtarë për të ndërtuar një shoqëri me mundësinë për të organizuar veten dhe për të mbrojtur atë nga armiqtë.

Me ndihmën hyjnore këtë përgjigje e gjeti tek ensarët – banorët medinas. Ata u takuan me Profetin në sezonin e haxhit, dëgjuan prej tij, i besuan dhe u përgatitën që qytetin e tyre ta bëjnë bazë për thirrjen dhe shtetin e pritur, për shoqërinë islame paqësore duke i dhënë mbështetje për gjithë atë që kërkonte ky organizim.

Organizimi profetik përfshirë këtu menaxhimin dhe funksionet e umetit ishte një themel nga ku u nxor teoretizimi i sistemeve islame, menaxhimi me shtetin dhe shoqërinë. Kur ju bëhej padrejtësi shokëve të tij, ai i përgëzonte se do vijë dita kur padrejtësia do të ndalohet ndërsa drejtësia do të zbatohet dhe jo vetëm në Mekë por edhe në shumë vende të ndryshme që ata i njihnin. Kur iu ankua Habab b. Eretti për torturat që përjetonte dhe i kërkoi të lutej kundër atyre që i kishin bërë padrejtësi, Profeti i tha: “Allahu do ta plotësojë këtë fe aq sa udhëtari do të udhëtojë nga San'a deri në Hadrameut dhe nuk do t'i frikohet askujt përveç Allahut dhe dhe ujkut për dhent e tij”<sup>1</sup>

Premtimi i Allahut se Islami do të ngadhënjente, se tokën do ta udhëhiqnin dhe dominonin muslimanët nënkuptonte ngritjen e një organizimi dhe sistemi nëpërmjet të cilit do të realizohej mirëqenia që do bashkonte mes ligjëvënies dhe praktikimit në jetën reale duke udhëhequr jetën nëpërmjet fesë. Ky premtim ishte i qartë në fjalët e të madhërishmit: “Atyre nga mesi juaj të cilët besuan dhe bënë vepra të mira, All-llahu u premtoi se do t'i bëjë zotërues në atë tokë ashtu si i pat bërë zotërues ata që ishin para tyre dhe fenë të cilën Ai e pëlqeu për ta, do ta forcojë, e në vend të frikës Ai do t'ju dhurojë siguri. Ata më adhurojnë Mua e nuk më shoqërojnë asgjë. E kush edhe pas kësaj mohon, të tillët janë ata më të prishurit.” (Nur:55)

‘Zotërimi në tokë’ nënkuptonte sundimin, organizimin, udhëheqjen dhe menaxhimin e saj.

---

<sup>1</sup> Buhariu në Sahihun e tij, Kitabul megazi, 5/238

Profeti e kishte të qartë që sistemi islam politik që u ngrit për të do të trashëgojë sistemet botërore të asaj kohe siç ishte pushteti i perandorëve pers dhe cezarëve romak. Xhabir b. Semure trnamseton fjalët e profetit: “pa dyshim që tokën e kisras do ta çlirojë një grup i muslimanëve”<sup>1</sup>

Poashtu, gjersa po hapnin hendekun, pas një goditjeje, Profeti tha: “Allahu ekber, m’u dhanë çelësat e Shamit, pasha Allahun po i shoh pallatet e kuqe në këtë çast, pastaj goditi sërish dhe tha: Allahu ekber m’u dhanë çelësat e Persisë, pasha Allahun, po e shoh pallatin e bardh të Medainit, më pas goditi për së treti dhe tha: Allahu ekber, m’u dhanë çelësat e Jemenit, në këtë çast po shoh dyert e San’asë nga ky vend.”<sup>2</sup>

Ai, pra, i edukonte shokët e tij me bindjen e përhapjes së Islamit dhe shtetit në anët e ndryshme të tokës në një organizim institucional, fetar, administrativ politik.

Profeti, qysh në ditët e para të thirrjes së tij u përpoq të ngrit një sistem human që do i udhëhiqte njerëzit kah drejtësia dhe barabarësia. Ai ushtroi detyrën e udhëheqësit suprem në shtetin islam dhe në të njejtën kohë kishte privilegjin e të qenit profet ndërsa shokët e tij i përgatiti që pas tij të organizojnë botën dhe të realizojnë monoteizmin dhe drejtësinë.

### **Karta e Medines (organizimi qytetar i shoqërisë)**

Profeti erdhi që të ndërtojë një shoqëri humane e të drejtë ku të drejtat, dinjiteti dhe siguria e njeriut nuk do të cenohen. Ai erdhi me fenë e vërtetë: “E kush kërkon fe tjetër përveç fesë islame, atij kurrsesi nuk do t’i pranohet dhe ai në botën tjetër është nga të dëshëpruarit.” (Ali Imran: 85)

Njerëzit ishin të lirë të përqafonin ose jo Islamin: “Në fe nuk ka dhunë. Është sqaruar e vërteta nga e kota. E kush nuk i beson të pavërtetat e i beson All-llahut,

---

<sup>1</sup> Shiko: Sire nebevije, Ibn Is-hak fq: 271

<sup>2</sup> Imam Ahmedi në Musned, disa nga dijetarët e kanë vlerësuar me gradën ‘hasen’ (shiko: Siretun-nebevije-sahiha: d-r. Ekrem Dija el-Umerij 2/423)

ai është kapur për lidhjen më të fortë, e cila nuk ka këputje. All-llahu është dëgjues i dijshtëm.” (Bekare:256) Njerëzit pra ishin të lirë, pasi t’u vinte lajmi. Kur Profeti shkoi në Medine, muslimanët ishin pakicë krahasuar me të tjerët siç ishin hebrenjtë dhe politeistët, megjithatë u kujdes që të gjejë një gjuhë të përbashkët me të gjithë, të shkruajë një marrëveshje mes tyre që do garantonte dhe ruante të drejtat e tyre si dhe do siguronte bashkëjetesën në Medine.

Profeti kontriboi në rregullimin e raporteve ndërmjet banorëve muslimanw dhe të tjerëve. Ai qysh në një fazë të hershme shkroi një dokument për këtë,<sup>1</sup> “Profeti me të ardhur në Medine, bëri marrëveshje paqësore me hebrenjtë, e shkroi dokumentin mes tyre, ju vuri kusht që të mos e ndihmonin armikun e tij por të ishin në anën e tij kundër çdonjërit që do ta sulmonte atë”<sup>2</sup> bëhet fjalë për atë që njihet si Karta e Medines.

Kjo Kartë apo Fletushkë siç e qujatën disa, ose Kushtetua e përbashkët sipas disa të tjerëve<sup>3</sup> është e vërtetuar dhe është shkruar në fillim të hixhretit, para dërgimit të ekspeditave ushtarake dhe luftërave të tij. Janë përcjellur versione të ndryshme të kartave dhe shkresave që kishin ndodhur mes profetit e muslimanëve dhe hebrenjëve e të tjerëve nga banorët e Medines që nuk e mohojnë kartën e parë e as që e kundërshtojnë.

Karta paraqiste “një shkresë pajtueshmërie, fqinjësi të mirë, të ishin paqësorë ndaj tij (Profetit), të mos i ndihmojnë armikut të tij si dhe të rreshtoheshin me të kundër gjithë atyre që kërcënonin sigurinë e Medinës së ndritur”<sup>4</sup>

Kjo marrëveshje nënkupton ngritjen e një sistemi në krye të së cilit ishte Profeti, caktim të përgjegjësisive të sigurisë dhe mbrojtje për të gjithë qytetarët, duke mos i imponuar asnjërit fenë e tjetrit, sidomos kur dihet se në këtë periudhë Medineja kërcënohej fuqishëm nga politeistët mekas të cilët lëshonin kërcënime një pas një.

---

<sup>1</sup> Sire nebevije, Ibn Hisham 1/501

<sup>2</sup> El-Beladherij, Ensabul eshraf 1/86

<sup>3</sup> Salih Shamij, Min muin es-sireh fq: 180

<sup>4</sup> Abdulhamid Tuhmaz, Siretun-nebij, fq: 273

Në këtë marrëveshje as që bëhej fjalë për largimin e hebrenjëve apo ndonjë banori tjetër nga banorët e Medines jomuslimanë përderisa ata ju përmbaheshin kushteve të jetës së përbashkët, paqës së përgjithshme shoqërore që mund të jetë e ngjashme me bashkëatdhetarinë, duke ruajtur çdo komunitet të drejtën e tij në fe e besim.

Kjo marrëveshje civile llogaritet shembulltyrë e një organizimi të drejtë, një përgjegjësi shoqërore, referencë administrative e shkruar me gjithw analfabetizmin e Profetit. Ajo ju ngjanë disa sistemeve administrative moderne në të cilat sigurohet liria e religjiozitetit dhe mosimponimi në besim, duke ruajtur sigurinë, organizimin e përbashkët dhe përgjegjësinë shoqërore. Kjo marrëveshje konsiderohet themeli mbi të cilin u ngrit shteti profetik i Medines, përgjegjësia e të cilit ishte në dorën e Profetit, një parrapërgatitje për zbatimin e sheriatit sipas mënyrës së shpalljes, duke e lënë këtë përgjegjësi në dorën e njeriut më të drejtë.

### **Zhvillimi i Medines dhe shoqërisë së saj**

Islami synon që bindjen ndaj Allahut ta bëjë të dashur te shoqëritë ndërsa monoteizmin synon të ngritë nivelin e dinjitetit të tyre, fuqizon organizimin, shton prodhimin, mbron ambientin dhe tokën nga degjenerimi dhe e gjallëron me gjëra që i bëjnë dobi njerëzimit. Medineja ishte një shembull për gjithë këtë. Profeti e organizoi atë me ligje të ndryshme, udhëzime dhe akte administrative, aplikuese civile. Kjo i bëri të gjithë të bëjnë garra për prodhim dhe produktivitet e jo të bëhen dembelë, të mbështeten te të tjerët, të jenë pesimist dhe negativ. Kjo u bë e qartë për Medinen e cila u zhvillua dhe u ndryshua gjendja e saj pasi u shpërngul në të Profeti.

Fillimi i ndryshimit fshihej në gjëra abstrakte që në dukje kishin rëndësi të madhe, e para prej tyre:

#### *Ndryshimi i emrit të Medines:*

Medineja para Islamit njihet në mesin e arabëve me emrin Jethrib që d.m.th. diçka e qortuar. Ky emër është përmendur në Kuranin Fisnik: “Dhe kur një grup prej



tyre thanë: "O banorë të Jethribit, nuk ka qëndresë për ju, ndaj kthehuni!" E një grup prej tyre kërkoi lejen e Pejgamberit, duke thënë: "Shtëpitë tona janë të pambrojtura!" Edhe pse ato nuk ishin të pambrojtura, në realitet ata nuk donin tjetër por vetëm të iknin." (Ahzab: 13)

Profeti e urrente këtë emër dhe urdhëroi të zvwndwsohet me emrin Medine<sup>1</sup> dhe siç dihet kjo fjalë d.m.th. qytetërim, civilizim dhe stabilitet si dhe gjëra që nënkuptohen sikur: punë, organizim, drejtësi e tjerë, që kanë të bëjnë me qytetërimin dhe shoqërinë e tij.

Në Kuran, Medineja është përmendur katër herë:

"Edhe rreth jush ka beduinë që janë hipokritë, e edhe nga banorët e Medines që janë përcaktuar për hipokrizi. Ti nuk i di ata, Ne i dimë, ata do t'i dënojmë dy herë, pastaj shtyhen në dënimin e madh." (Teube: 101)

"Nuk ishte me vend për banorët e Medines e as për ata që ishin rreth tyre nga beduinët, të ngelin (pa shkuar) pas të dërguarit të All-llahut e as të kursejnë veten e tyre ndaj vetes së tij (Pejgamberit). Nuk ishte me vend ngase ata nuk i godet as etja, as lodhja, as uria kur janë në rrugën e All-llahut, dhe nuk shkelin ndonjë vend që i hidhëron mosbesimtarët, dhe nuk arrijnë kundër armikut çkado qoftë (mbytje, robërim të tyre ose ngadhënjim mbi ta), vetëm se të gjitha ato do t'u evidentohen atyre si vepër e mirë (shpërblyese). All-llahu nuk ua humb shpërblimin veprimmirëve." (Teube: 120)

"Po nëse hipokritët dhe ata që kanë zemra të sëmura, dhe ata që përhapin gënjeshtër në Medine, nuk ndalen, Ne do të bëjmë që ti të dominosh mbi ta e pastaj ata nuk do të jenë fqinj me ty në të, vetëm një kohë të shkurtër." (Ahzab:60)

"Ata thonë: "Nëse do të kthehemi (prej luftës me Beni Mustalikët) në Medine, ai më i forti patjetër prej aty ka për ta përzënë atë më të dobëtin!" (ashtu thanë) Ndërsa e tërë krenaria i takon All-llahut, të dërguarit të Tij dhe besimtarëve, por hipokritët këtë nuk e dinë." (Munafikun: 8)

---

<sup>1</sup> Er-Rifai, El-Ehadith elvaride fi fadail Medine, fq: 301

Profeti e emërtoi edhe me emra të tjerë sikur: Tabe, Tajjibeh, El-Mubarekeh, El-Mushrifeh, Darul iman, El-Hasineh, që të gjitha këto emërtime sinjalizojnë bukurinë e emrit dhe japin optimizëm<sup>1</sup>.

*Dashuria ndaj Medines dhe shndërrimi i saj në harem:*

Profeti u kujdes që Medineja të ketë shenjtërinë e saj. Ai i caktoi kufijtë e saj dhe u lut për të siç është shënuar në Sahihun e Buhariut: “Ibrahimi e bëri harem Mekën dhe u lut për banorët e saj, ndërsa unë e shpall Medinën harem mes dy shkëmbishtëve”<sup>2</sup>, Profeti githashtu bëri këtë lutje: “O Allah! Na e bën të dashur Medinën ashtu siç e duam Meken ose më shumë!”<sup>3</sup> Nuk ka dyshim që dashuria ndaj një vendi nënkupton ruajtjen e tij, kujdesin dhe qëndrimin në të.

Profeti solli një sërë ligjesh për mbrojtjen e ambientit dhe jetës natyrale në Medine, ai tha: “Ibrahimi e shpalli Mekën harem ndërsa unë e shpall harem Medinën. Është e ndaluar brenda dy shkëmbishtëve dhe kufijve të saj të këputen bimët, të përzihet gjahu, të përvetësohen gjërat e humbura përveç atij që i lajmëron ato, të priten pemët përveç kur ndonjëri ushqën devenë e tij dhe nuk barten armët e luftimit”<sup>4</sup> Këto ligje profetike kanë kontribuar në mbrojtjen e ambientit natyror të Medines.

Profeti i lavdëroi banorët e Medinës, vendasit, ata që strehoheshin dhe shpërnguleshin aty, ai ka thënë: “Imani kthehet në Medine ashtu siç kthehet gjarpëri në vrimën e tij”<sup>5</sup>

Muslimi një kapitull e quajti “Nxitja për të banuar në Medine” dhe ajo që përdorin njerëzit shkurtimisht nga ky hadith i gjatë është pjesa: “Medineja është më mira për ta sikur ta dinin”<sup>6</sup>

Ka shumë fjalë profetike që ngërthejnë lutje për të bekuar Medinen, prej tyre: “Ibrahimi e shpalli harem Mekën dhe u lut për të ndërsa unë shpalla Medinën

---

<sup>1</sup> Er-Rifai, El-Ehadith elvaride fi fadail Medine, fq: 305

<sup>2</sup> Sahih Buhari 4/40

<sup>3</sup> Sahih Buhari, hadithi nr: 3926, Muslimi nr: 1376

<sup>4</sup> Ahmedi në Musnedin e tij 1/119

<sup>5</sup> Buhariu dhe Muslimi

<sup>6</sup> Buhariu dhe Muslimi

harem ashtu siç shpalli Ibrahim Mekën dhe u luta për (t'u bekuar) muddi dhe sai<sup>1</sup> i saj ashtu siç u lut Ibrahim.”<sup>2</sup> Poashtu kjo vvrehet në lutjen e tij: “o Allah, na bën të dashur Medinen ashtu siç e duam Meken apo më shumë, o Allah! Bekoje sa-in dhe mundin tonë...”<sup>3</sup>

### *Ndërtimi i xhamisë profetike:*

Nga punët e para të profetit në Medine ishte caktimi i vendit të xhamisë së tij. Deveja ishte ndaluar në vendin ku do ndërtonte xhaminë<sup>4</sup>. Në atë vend faleshin disa nga muslimanët. Kishte qenë një vend ku thaheshin hurmat, pronë e Suhelit dhe Sehlit – dy djelmosha jetimë që qëndronin nën përkujdesjen e Es'ad b. Zurare. Kur u ndal në atë vend deveja, ai tha: “ky është vendi, dashtë Allahu”. Më pas Profeti thirri djelmoshat për të bërë pazar për vendin. Ata thanë: po ta dhurojmë o i Dërguar i Allahut, mirëpo Profeti nuk pranoi ta merr si dhuratë, prandaj e bleu dhe aty e ndërtoi xhaminë.<sup>5</sup>

Brenga e Profetit ishte ndërtimi i një xhamie në të cilën do të adhurohej vetëm Allahu dhe askush tjetër pos Tij, mirëpo pa marrë asgjë nga pasuria e atyre jetimëve e as nga pasuria e të tjerëve, megjithëse profeti pranonte dhuratat, mirëpo jo edhe në këtë rast. Ai urdhëroi t'ju paguhet fëmijëve nga pasuria e tij. Kjo xhami konsiderohet vakfi i parë në Islam, ndërsa vakifi ishte i Dërguari i Allahut.

Kjo xhami u rindërtua dhe u zgjerua pas Betejës së Hajberit<sup>6</sup>. Kufijtë e xhamisë profetike janë të njohura edhe sot e kësaj dite. Janë të shënuara me shenja të gjelbërta, të shkruara qartë dhe secili vizitues i xhamisë mund t'i sheh dhe lexojë.

### *Zhvillimi i natalitetit dhe barazpesha e tij:*

---

<sup>1</sup> Mudd: masë matëse që përfshin dy duart e mbushura plot; sa': pjatë e kohës profetike që përmbante katër mude. Sh.p.

<sup>2</sup> Buhariu dhe Muslimi

<sup>3</sup> Buhariu dhe Muslimi

<sup>4</sup> Ibën S'ad: Sire nebevije min Tabekat 1/237

<sup>5</sup> Versioni i Buhariut në Sahihun e tij.

<sup>6</sup> Ibën Kethir. Sire Nebevije 3/345

Profeti shpresonte në shtimin e lindshmërisë te besimtarët. Ai dhe besimtarët u gëzuan me të lindurin e parë nga muhaxhirët, pas shpërnguljes. Buhariu ka shënuar nga Esmā b. Ebu Bekër e cila ka thënë: “isha shtatzënë me bashkëshortin Abdullah b. Zubejr. Duke qenë nëntëmuajshe, shkova në Medine, para kësaj u ndalëm në Kuba dhe aty lindi. Ia solla Profetit foshnjen dhe ai e mori në prehër, kërkoi një hurmë, e përtypi pastaj ia fërkoj gojën me të. Gjëja e parë që u fut në barkun e foshnjes ishte pështyma e Profetit. Pastaj ia fërkoj gojen me hurmë. U lut që të ishte i bekuar. Ai ishte i linduri i parë në Medinë.”<sup>1</sup>

Udhëzimet profetike që vinin në theks shtimin e natalitetit së bashku me edukimin e mirë nuk mungonin, ai thoshte: “martohuni me gra që dashurojnë dhe lindin, unë do të mburrem ditën e kiametit me nurmin tuaj të madh para umeteve tjera”<sup>2</sup>

Në Kuran janë përmenduar disa ajete që udhëzojnë në ruajtjen e fëmijëve dhe vënë në dije se furnizimi i tyre dhe prindërve të tyre është në dorë të Allahut: “Ju mos i mbytni fëmijët tuaj nga frika e varfërisë, se Ne ua sigurojmë furnizimin atyre dhe juve, e mbytja e tyre është mëkat i madh.” (Isra: 31)

Statistika e parë e njohur në Islam është ajo e periudhës profetike. Është përcejlur se profeti kishte dhënë urdhër: “rregjistroni çdonjërin që deklaron Islamin. Hudhejfe tregon: rregjistruam një mijë e pesëqind burra.”<sup>3</sup> Ky ishte një interesim direkt për njohjen e resurseve njerëzore. Profeti orinetonte çdonjërin për atë që ishte adekuat.

Është e njohur se Profeti nxiste për t’u shpërngulur në Medine, megjithatë ai kujdesej në planifikimin e gjërave, të mos dilej jashtë kufijve, të mos bëhej rrëmujë duke dalur nga organizimi i qytetit që do shkaktonte problem në strukturën e popullsisë. Për këtë arsye kur disa fise pranuan Islamin dhe dëshën që të shpërnguleshin komplet në Medine, Profeti i udhëzoi të qëndronin në vendin e tyre, të mësonin nga njëri tjetri dhe të ishin të gatshëm të praninin

---

<sup>1</sup> Sahih Buhari hadithi nr: 3909

<sup>2</sup> Ahmedi në Musned 3/245

<sup>3</sup> El-Huzai, Tahrixh delalat sem’ije, fq: 230

urdhërat e tij<sup>1</sup>. Ngjashmë me kwtw ishte ndërperja e shpërnguljes pas çlirimit të Mekes<sup>2</sup> që nënkupton kontrollimin e numrit të banorëve në Medine dhe vendet tjera.

Jo vetëm kjo, por edhe shpërndarja e banorëve brenda Medines ishte i rëndësishëm. Kur profeti ndërtoi xhaminë e tij dhe ensarët mësuan për vlerën e saj dhe faljës në të, fisi Benu Selemeh deshën t'i linin shtëpitë e tyre në periferi të Medines dhe të afroheshin me banim afër xhamisë profetike, mirëpo ai nuk i inkurajoi për një gjë të tillë. Transmetimi i Enesit thotë: “Benu Selemeh deshë të transferoheshin afër xhamisë, mirëpo profeti nuk pëlqente të zbrazej Medineja. Ai ju tha: Benu Selemeh! Pse s’po llogaritni (shpërblimin e) hapat tuaja, dhe ata nuk lëvizën.”<sup>3</sup>

### *Zhvillimi cilësor*

Rritja e numrit të banorëve pa i kushtuar rëndësi zhvillimit cilësor është e pavlerë. Për këtë, Profeti ishte i interesuar që çdo musliman të ndiej vlerën dhe pozitën e tij pa u bërë mendjemadh, duke ia shoqëruar kësaj frikën dhe nënshtrimin ndaj Allahut, butësinë ndaj muslimanëve dhe mëshirën të gjitha krijesave. Kjo e bën të domosdoshme ushqimin e moralit shpirtëror dhe forcimin e tij te secili individ, ndërtimin e vetëbesimit qysh në fillim të jetës, forcimin e anës psikologjike duke nisur që nga emri me të cilin thirret njeriu, prandaj Profeti kujdesej që emërtimet të bëheshin me emrat më të bukur<sup>4</sup>, madje ndodhte edhe të ndërroheshin emrat e shëmtuar. Mu për këtë profeti mernte pjesë në emërtimin e shumë foshnjeve në kohën e tij si p.sh. Abdullah b. Zubejrin<sup>5</sup>, Hasenin, Husejnin dy djemt e Aliut<sup>6</sup> dhe të tjerë nga ata që lindën në Medine pas hixhretit. Nga ana tjetër, ai ua ndërroi emrat disa muhaxhirëve. Njëri nga ata quhej Xhuajl dhe e emërtoi Amër. Ai inkurajonte të rinjtë dhe njerëzit në përgjithësi duke i thërritur me emrat dhe

---

<sup>1</sup> Amër b. Shebeh, Tarihul Medine 2/482-488

<sup>2</sup> Ibën Ebu Shejbe, El-Megazi fq: 347, Amër b. Shebeh, Tarihul Medine 2/483

<sup>3</sup> Buhariu nr: 1887

<sup>4</sup> Meusuatu hukukil insane fil islam, Adnan veza, 5/35

<sup>5</sup> Ibën Ebu Shejbe, El- Megazi fq: 153

<sup>6</sup> El-Muajeshune lirresul

nofkat e tyre më të dashura. Të vegjëlve ju drejtohej me fjalët ‘biri im’! I thërriste me kunjet e tyre. Vëllain e vogël të Enes b. Malikut e thërriste me kunjen ‘o Ebu Umejr’!. E tërë kjo për sa i përket individëve. Kur bëhet fjalë për umetin e Muhamedit në përgjithësi, Allahu i madhëruar për të tha: “Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve” (Ali Imran: 110) Pas kësaj thirrjeje a mbetet inferioritet dhe ngecje? Ai e ngriti namin e umetit të tij në mes umeteve tjerë, si individ dhe si shoqëri.

### *Zhvillimi arsimor:*

Islami qysh me zbritjen e ajeteve të para të Kuranit që i zbritën profetit analfabet, erdhi që t’na kujtojë dijen dhe lapsin, Allahu i madhëruar thotë: “Lexo me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi (çdo gjë). Krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur (në mitrën e nënës). Lexo! Se Zoti yt është më bujari! Ai që e mësoi (njeriun) të shkruajë me pendë. Ia mësoi njeriut atë që nuk e dinte.” (Alek: 1-5)<sup>1</sup> Kjo ngjau në një kohë kur arabët i udhëhiqte injoranca, analfabetizmi, bestytnitë dhe legendat me një prani gati minimale të arsimit në qendrat qytetare.

Profeti u shpërngul në Medine dhe vazhdonte të nxiste në dituri, arsim dhe mësim, të ngrejë pozitën e diturisë në shpirtat e muslimanëve. S’ka dyshim se kjo gjë linte gjurmë në shoqërinë medinase, në aspektin e zhvillimit arsimor, prandaj ndejat e tyre ishin ndeja të diturisë.

Shokët e profetit lexonin fjalët e të Madhërishmit: “O ju që besuat, kur t’ju thuhet: zgjerohuni (bëni vend) në vend ndeje, zgjerohuni, se All-llahu bën zgjerim për ju, e kur t’ju thuhet: ngrihuni! Atëherë ju ngrihuni, All-llahu i lartëson ata që besuan prej jush, i lartëson në shkallë të lartë ata të cilëve u është dhënë dituri. All-llahu është i njohur mirë me atë që punoni.” (Muxhadele: 11)

Buhariu në Sahihun e tij një kapitull e titulloi “Dituria” dhe nën të përmendi pesëdhjetë e tre nëntituj. Aty përmendi një sërë hadithesh dhe komentoi ajete të ndryshme si p.sh. ajetin: “(A jobesimtari e ka gjendjen më të mirë) Apo ai që

---

<sup>1</sup> Për më gjërë, konsultu librin “Ikre bismi rabbik” Muhamed b. Ahmed El-Harbij

kohën e natës e kalon në adhurim, duke bërë sexhde, duke qëndruar në këmbë, i ruhet (dënimit të) botës tjetër dhe shpreson në mëshirën e Zotit të vet? Thuaj: "A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?" Po, vetëm të zotët e mendjes marrin mësim." (Zumer: 9) dhe ajetin: "Të pyesin ty për shpirtin; Thuaj: "Shpirti është çështje që i përket vetëm Zotit tim, e juve ju është dhënë fort pak dije"." (Isra: 85) dhe ajetin: "Edhe nga njerëzit, nga gjallesat, nga kafshët po ashtu ka të ngjyrave të ndryshme. Po All-llahut ia kanë frikën nga robërit e Tij vetëm dijetarët, All-llahu është mbi gjithçka, është mëkatfalës." (Fatir: 28)

Ndërsa, profeti ka thënë: "S'ka zili përpos në dy gjëra: njeriun të cilit Allahu i ka dhënë pasuri dhe ai e harxhon në rrugë të drejtë dhe njeriun të cilit Allahu i ka dhënë urtësi dhe ai gjykon dhe vepron sipas saj"<sup>1</sup>

Profeti e kishte zakon që të arsimuarin ta urdhërontë t'i mësojë të tjerët. Ai e urdhëroi delegacionin e Abdul Kajsit që të mësonin popullin e tyre. Atyre jut ha: "kthehuni te familjet e juaja dhe mësoni ato"<sup>2</sup>

Shkrimi në Medine kryesisht zotërohej nga hebrenjtë. Ata e njihnin shkrim-leximin dhe i mësonin fëmijët e tyre në atë që njiheshin si shkolla.<sup>3</sup> Ata mësonin shkronjat hebreje dhe me to shkruanin fjalët arabe. Prej hebrenjëve mësuan disa nga fisi Eus dhe Hazrexh, dhe disa nga ensarët – shkruarit e profetit.<sup>4</sup> Muslimanët njihnin vlerën e shkrimit qysh para hixhretit. Këtë e gjejmë në faktin se Fatime bint Hattab dhe bashkërshorti i saj Seid b. Zejd, në Mekë lexonin suren Taha së bashku me Habab b. El-Eret-in në një fletushkë, në çastin kur Omer b. Hatabi hyri në shtëpinë e tyre dhe zbuloi se ata kishin pranuar Islamin.<sup>5</sup>

Mësimi i shkrim-leximit u bë synim i shumë shokëve të Profetit pas shpërnguljes në Medine. Ubade b. Samit ua mëson të Ehlul Suffes shkrim-leximin.<sup>6</sup>

Pas luftës së Bedrit, një numër i robërve nga politiesitët që dinin shkrim-lexim dhe që nuk kishin pasuri të paguajnë për lirimin e tyre, profeti pranoi që të lironte ata

---

<sup>1</sup> Buhariu, hadithi nr: 73

<sup>2</sup> Buhariu, hadithi nr: 87

<sup>3</sup> "El-Medinetu fil asril xhahilij", fq: 99, Muhamed El-Id El-Hatravij

<sup>4</sup> Kuttibun-Nebij, Mustafa E'adhamij

<sup>5</sup> Sire nebevije, Ibn Hisham, 1/345

<sup>6</sup> Elmuxhtema elmedenij fi ahdi nubuvveh, d-r. Ekrem El-Umerij fq: 96

me kush që secili prej tyre t'ua mëson të dhjetë fëmijëve shkrim-leximin. Me këtë rast, një numër i madh i fëmijëve të ensarëve mësuar shkrim leximin dhe kjo ndikoi në përhapjen e shkrim-leximit në shoqërinë medinase. Nuk ka mëdyshje se këta të arsimuar kanë dhënë mundin e tyre në mësimin e të tjerëve. Pas kësaj, mbase kujdesi për të shkruar Kuranin dhe Sunetin që nisi që në ditët e Profetit, llogaritet nga shkaqet më të rëndësishme të përhapjes së shkrimit. E njëjta ndodhi edhe me shkruarit e profetit të cilët morrën pjesë në shkresat të cilat profeti ua dërgoi mbretërve dhe princërve të botës, numri i tyre arriti deri në gjashtëdhjetë shkruar.<sup>1</sup>

Mbase, rëndësia e të drejtave ndaj të tjerëve dhe domosdoshmëria e dokumentimit të tyre llogaritet shtytës kryesor për paraqitjen e shkrimit. Në këtë aludon ajeti më i gjatë kuranor që njihet si “Ajete i huasë”: “O besimtarë, kur merrni hua prej njëri-tjetrit për një afat të caktuar, shkruajeni atë. Dhe nga gjiu juaj le të shkruajë një shkruar i drejtë...” (Bekare: 282)

Nga periudha profetike është e njohur se disa gra zotëronin shkrimin dhe ua mësonin grave tjera. Kjo mund të jetë nga inkurajimi i Profetit dhe s'ka dyshim se ka ndodhur me pëlqimin e tij. Është transmetuar se Profeti i kishte thënë Shifa bint Abdullah - rrjedhte nga Benu Adij ibën K'ab nga kurejshët, kishte pranuar Isalmin dhe ishte shpërngulur në Medine - : “Sikur t'ia mësoje Hafsës yshtjen e milingonës ashtu siç i mësove shkrimin!”<sup>2</sup>

Nëse Shifa ia mësoi nënës së besimtarëve – Hafsës, shkrimin, atëherë nuk është larg mendjes që të kishte mësuar edhe të tjera gra. Poashtu ka pasur edhe gra të tjera mësuëse në periudhën profetike<sup>3</sup>. Në e dimë me siguri që nxitja për dituri dhe për të mësuar që është cekur në Sunet dhe para kësaj në Kuran, nuk është e veçantë vetëm për burrat, por e përgjithshme, për tërë umetin përfshirë të gjitha strukturat, moshat dhe grupet.

---

<sup>1</sup> Kuttibun-Nebij, Mustafa E'adhamij, fq: 179. Shiko dhe: El-vethaik essijasijeh lil ahdin-nebevij uel hilafetir-rashideh – Muhamed Hamidullah dhe Kuttatul vahji - Ahmed Abdurahman Isa.

<sup>2</sup> Ibn Kajim, Zadul mead, 3/24

<sup>3</sup> Abdulaziz El-Umerij, Elhiref ue sinaat fil Hixhaz fil asri nebevij, elkiraeh uel kitabe, fq: 35



Njohja e shkruesve në Medine para shpërnguljes së Profetit dhe rritja e numrit të tyre pas shpërnguljes afërsisht katër vjet, na flet për faktin sa shumë u përhap shkrimi në Medine nën ndikimin direkt të Profetit, ligjeve shariatike dhe zbatimi i tyre. Mendohet që numri u shtua tre ose katër herë më shumë. Duke vërtetuar, në të njejtën kohë se gjendja e profetit dhe analfabetizmi i tij ishte merkurulli për sa i përket atij: “Ti (Muhammed) nuk ishe që lexon ndonjë libër para këtij, e as që shkruajshe atë me dorën tënde të djathtë, pse atëherë do të dyshonin ata të prishurit.” (Ankebut: 48)

### *Zhvillimi social:*

Shoqëria medinase para Islamit dhe shpërnguljes së Profetit ashtu si dhe çdo shoqëri tjetër arabe, injorante, udhëhiqej nga doket dhe zakonet fisnore përplot injorancë edhe pse disa prej tyre ishin të mira. Aty ku gjendej Profeti – i Dërguari mëshirë për botërat – së bashku me të vinin edhe virtytet e larta, cilësitë e lavdëruara që i solli dhe të cilat sollën ndryshim social në shoqërinë medinase. Nga çështjet më të rëndësishme në zhvillimin shoqëror ishte përhapja e lëmoshës, zekatit dhe mbrotja e nevojtarëve. Kjo gjë solidarizonte shoqërinë. Pjesë e kësaj ishte ajo që ndodhi mes muhaxhirëve dhe ensarëve dhe ajo që ju ndodhi nevojtarëve në përgjithësi, madje lëmosha dhe bamërsia që ju destinohej jomuslimanëve, duke ja shtuar kësaj edhe udhëzimet profetike që njerëzit të përmbahen dhe të pamvarësohen nga të tjerët.

Ekzistonin disa burime të të ardhurave që ndikonin në dëgjënërim moral dhe social të cilat Profeti i luftoi sikur: prostitucioni. Islami ishte i prerë në ndalimin dhe saknionimin e tij ngase ai është një nga dyert kryesore të degjenerimit social dhe familjar, humbjen e prejardhjes familjare, shfaqjen e sëmundjeve shpirtërore dhe nëpërkëmbjën e përgjegjësive dhe prishjen e lidhjeve farefisnore. Ky qëndrim i prerë ndaj prostitucionit shihet në ajetin kuranor: “dhe ata të cilët e ruajnë nderin e vet (sa i përket jetës intime), Me përjashtim ndaj grave të veta (me kurorë) dhe ndaj atyre (robërshave) që i kanë në pronësinë e vet, për të cilat nuk janë të qortuar” (Muminun: 5,6)

Poashtu bashkëshortët i ngarkoi obligime të caktuara, i urdhëroi të kenw respekt, raporte të mira, dashuri, mëshirë dhe bamirësi të ndërsjellë. Profeti të gjitha këto i jetësoi në raport me gratë e tij dhe ishte shembull i gjallë i këtij aspekti të jetës.<sup>1</sup>

Alkooli përfaqësonte një barrë të madhe mbi shoqërinë. Llogaritej si një nga burimet e krenarisë tek arabët. Islami e ndaloi gradualisht gjersa e llogariti nga mëkatet e mëdha<sup>2</sup>. Kështu, sjellja e shumë njerëzve ndryshoi me ndalimin e tij.

Islami erdhi për të forcuar lidhjet shoqërore, prandaj lidhjet farefisnore i konsideroi ndër adhurimet më të mëdha. Interesimi për të afërmit, bamirësia ndaj tyre, ofrimi i ndihmës materiale është një nga dyert e shpërblimit të madh shoqëruar me monoteizmin dhe drejtësinë: “Udhëzimi për në rrugë të drejtë i takon All-llahut e ka edhe rrugë që është e shtrembër. Po sikur të kishte dëshiruar Ai, do t'u kishte udhëzuar që të gjithëve.” (Nahël: 9)

Bamirësinë ndaj prindërve e bëri detyrim fetar dhe e përmendi së bashku me bindjen ndaj Allahut: “Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë që të mos adhuroni tjetër pos Tij, që të silleni në mënyrë bamirëse ndaj prindërve. Nëse njërin prej tyre, ose që të dy, i ka kapur pleqëria pranë kujdesit tënd, atëherë mos u thuaj atyre as "of - oh", as mos u bë i vrazhdë ndaj tyre, po atyre thuaju fjalë të mira (të buta, respektuese).” (Isra: 23)

Raportin e mirë me fqinjin e bëri poashtu detyrim fetar: “Adhurojeni All-llahun e mos i shoqëroni Atij asnjë send, silluni mirë ndaj prindërve, ndaj të afërmeve, ndaj jetimëve, ndaj të varfërve, ndaj fqiu të afërt, ndaj fqiu të largët, ndaj shokut pranë vetes, ndaj udhëtarit të largët dhe ndaj robërve. All-llahu nuk e do atë që është kryelartë dhe atë që lavdërohet.” (Nisa: 36)

Bashkëpunimin në bamirësi dhe devotshmëri e bëri simbol të përgjithshëm shoqëror: “Ndihmohuni mes vete me të mira dhe në të mbara, e mosni në mëkate e armiqësi. Kini dro dënimit të All-llahut, se me të vërtetë All-llahu është ndëshkues i fortë.” (Maide:2)

---

<sup>1</sup> El-Kemedanij: Edib, Fen teamul nebij fil hayat zeuxhijeh, fq: 17

<sup>2</sup> Sahih el-Buhari: Kitabul eshribeh: hadithet prej 5575 deri në 5602

E gjithë kjo forcoi lidhjet shoqërore, e përmirësoi shoqërinë në Medinen e pas-hixhretit, e ngriti atw, rriti interesimin për njëri tjetrin dhe instaloi virtytin e fajljes ndaj njëri tjetrit<sup>1</sup>: “edhe ata që kur i godet e padrejta, i kundërvihen. Ndëshkimi i të keqes bëhet me një të keqe në të njëjtën masë, e kush fal e bën pajtim, shpërblimi i tij është tek All-llahu. Vërtet, Ai nuk i do zullumqarët.” (Shura: 39,40)

Shtoja kësaj edhe porositë e përgjithshme morale, mirësjelljen dhe zmbropsjen nga injorantët: “E robërit e Zotit janë ata që ecin nëpër tokë të qetë, e kur atyre me fjalë u drejtohen injorantët, ata thonë: "Paqe!"” (Furkan: 63), “(Robërit e Zotit janë) Edhe ata që nuk dëshmojnë rrejshëm dhe kur (rastësisht) kalojnë pranë të keqes, kalojnë duke e ruajtur karakterin e vet.” (Furkan: 72)

Gjithashtu urdhëroi që e keqja të kthehet me të mirw, kur është e domosdoshme: “Nuk është e barabartë e mira dhe e keqja. Andaj, (të keqen) ktheje në mënyrën më të mirë, se atëherë ai, me të cilin kishit njëfarë armiqësie, do të bëhet mik i afërt.” (Fussilet: 34)

Virtytet e moralit i vlerësoi si qëllimet më të larta të individit dhe shoqërisë: “O ju që besuat, nuk bën të tallet një popull me një popull tjetër, meqë të përqeshurit mund të jenë më të mirë nga ata të cilët përqeshin dikë tjetër, e as gratë me gratë e tjera, sepse mund të ndodhë që gratë e tjera të jenë më të mira se ato që përqeshin (duke e nënçmuar njëri-tjetrin) dhe mos etiketoni njëri-tjetrin me llagape. Pas besimit është keq të përhapet llagapi i keq. E ata që nuk pendohen, janë mizorë. O ju që keni besuar, largohuni prej dyshimeve të shumta, meqë disa dyshime janë mëkat dhe mos hulumtoni për zbulimin e të metave të njëri-tjetrit, dhe mos përgjoni njëri-tjetrin; a mos ndonjëri prej jush dëshiron të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur? Atë pra e urreni! Kini frikë nga ndëshkimi i All-llahut, e All-llahu është mëshirues, Ai pranon shumë pendimin.” (Huxhurat: 11,12)

Njerëzit i bëri të barabartë si dhëmbët e krehërit, nuk bëri dallime mes tyre. Kurani deklaroi që njerëzit kanë një zanafillë: “O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se te All-llahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër

---

<sup>1</sup> Ka shumë libra rreth ndryshimit social në periudhën profetike, prej tyre libri i Hana Liham: Hedju siretin-nebevije fit-tegjir el-ixhtimajj”

është ruajtur (këqijat), e All-llahu është shumë i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë.” (Huxhurat: 13)

Ndalo mendjemadhësinë dhe kryenëçësinë ndaj të tjerëve: “Dhe mos shtrembëro fytyrën tënde prej njerëzve, mos ec nëpër tokë kryelartë, se All-llahu nuk e do asnjë mendjemadh e që shumë lavdërohet.” (Lukman: 18)

Përmirësimin e shoqërive dhe botës në përgjithësi e bëri një nga qëllimet e përgjithshme të muslimanit: “Mos bëni çrregullime në tokë pas rregullimit të saj (me të ardhur të pejgamberëve) dhe luteni Atë duke pasur frikë (dënimin) dhe duke shpresuar (mëshirën). S'ka dyshim se mëshira e All-llahut është pranë atyre të mirëve.” (A'raf: 56)

Këshillimin për të vërtetën dhe durimin në të e bëri detyrim human: “Pasha kohën! Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt. Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositën njëri-tjetrin t'i përmbahen të vërtetës dhe që këshilluan njëri-tjetrin të jenë të durueshëm.” (Asër: 1-3)

Këto vlera shoqërore zunë vend në Medinën e Profetit dhe shoqërinë e saj pas shpërnguljes së Profetit në të. Ato shkaktuan një zhvillim shoqëror të pashembullt në historinë njerëzore. Ndikimi i tyre nuk u kufizua vetëm në Medinë dhe në periudhën profetike. Medineja me tu u shndërrua në ‘Tajbe’ (e bukur) siç e emërtoi Profeti.

Edhe adhurimet islame, që të gjitha të çojnë drejtë vlerave dhe të ndalojnë nga imoraliteti dhe punët e këqija, prej tyre është namazi: “Ti lexo atë që po të shpallet nga libri (Kur'ani), fal namazin, vërtet namazi largon nga të shëmtuarat dhe të irituarat, e përmendja e All-llahut është më e madhja (e adhurimeve); All-llahu e di ç'punoni ju.” (Ankebut: 45)

### *Zhvillimi shëndetësor:*

Medineja, para se të vijë në të Profeti, lëngonte nga një numër i problemeve shëndetësore, disa prej tyre lidheshin me ambientin, në veçanti banorët e saj vuanin nga ethet për shkak të arave dhe moçaleve që lidheshin me to. Profeti u

lut për të duke thënë: “o Allah! Na bën të dashur Medinen ashtu siç e duam Meken apo më shumë! O Allah, bekoje muddin, sain dhe ethet barti në Xhuhfeh!”<sup>1</sup> Nga lutja bëhet e qartë interesimi i Profetit për shëndetin e banorëve të Medines.

Profeti sëmurej sikur çdo njeri tjetër<sup>2</sup>. Ai inkurajonte njerëzit që të mjekoheshin<sup>3</sup> dhe të kërkonin ilaçe: “Allahu nuk ka zbritur ndonjë sëmundje pa zbritur edhe shërimin e saj.”<sup>4</sup> Në mënyrë permanente mjekohej. Theksin vëndonte mbi mjekimin natyror e të shëndetshëm siç është mjalti dhe të tjerë. Është transmetuar thënia e tij: “shërimi është në tre gjëra: pirjen e mjaltit, hixhamen dhe kaoterizimin (djegien me zjarr), unë umetin tim e ndaloj nga kaoterizimi”<sup>5</sup>

Profeti pati një qëndrim të prerë kundrejt bestytive të cilat shkaktojnë sëmundje shpirtërore dhe trupore sikur oguret dhe pesimizmi. Ai njerëzve ua rekomandoi optimizmin dhe urdhëronte përdorimin e disa bimëve si farën e zezë dhe të tjera.<sup>6</sup>

Sa i përket mjekësisë preventive, Profeti vendoi themelin e saj me fjalët: “kur të dëgjoni për paraqitjen e kolerës në një vend, mos hyni e nëse paraqitet në një vend ku ju ndodheni, mos dilni që aty.”<sup>7</sup> Ai poashtu vëndoi rregulla të rëndësishme në shëndetësi dhe mejkësinë preventive nëpërmjet dietave, mostepimit në të ushqyer dhe agjërimin obligativ e vullnetar. Prej këtyre fjalëve: “Biri i Ademit s’ka mbushur ndonjë enë më të dëmshme se sa stomaku i tij. I mjaftojnë atij disa kafshata për t’ia drejtuar korizin, nëse patjetër duhet ta bëjë (të ushqyerit), atëherë një të tretën për ushqimin e tij, një të tretën për pijen dhe një të tretën për frymëmarrjen.”<sup>8</sup>

Profeti miratonte thirrjen e mjekëve për të sëmurët, siç ndodhi me S’ad ibën Ebu Vekasin kur u sëmur në haxhin lamtumirës.<sup>9</sup>

---

<sup>1</sup> Buhariu, kitab fadail Medineh

<sup>2</sup> Munis Husejn, Et-Tarih es-sihij lir-resul, silsiletu ikre

<sup>3</sup> El-Fejruz Abadij, Sifru Seadeh

<sup>4</sup> Buhariu

<sup>5</sup> Buhariu

<sup>6</sup> Mu’nis Husejn, Et-Tarih es-sihij lir-Resul Silsiletu ikre.

<sup>7</sup> Buhariu

<sup>8</sup> Ibn Kajim, Zadul Mead, 3/68

<sup>9</sup> Ibën S’ad, Tabekat el-Kubra, Buhariu në Sahih

Ai luftonte magjinë dhe shkuarjen te fallxhorët, miratonte yshtjen e vërtetë (rukjen) prej Kuranit dhe lutjeve profetike. Gjatë jetës së tij u themelua spitali i parë në Islam. Rufejdeh El-Eslemije gjatë luftës së Hendekut ngriti një tendë në xhaminë e Profetit për të mjekuar të plagosurit. Aty Profeti e vëndoi S'ad ibën Muadhin pasi ishte plagosur në luftën e Hendekut. Ai tha: vendoseni në tendën e Rufejdes që ta kem më afër për vizitë.”<sup>1</sup>

Urdhërat e Profetit për higjienë e kujdes për pastrim kontribuan në lokalizimin e sëmundjeve dhe mospërhapjen e tyre. Porositë e tij për pastërti gjatë ushqimit, mënyrave e tij të ruajtjes dhe mbulimit kishin një rol të rëndësishëm në ruajtjen e shëndetit të përgjithshëm të njerëzve.

Profeti nxiti synetimin dhe disa pastrime trupore që kontribuonin në kufizimin e sëmundjeve dhe mikrobeve, ai thoshte: “pesë gjëra janë nga natyrshmëria e pastër: synetimi, pastrimi i vendeve të turpshme, prerja e thonjëve, pastrimi i nënsqetullave dhe shkurtimi i mustaqeve”<sup>2</sup>

Këto udhëzime patën ndikimin e tyre në Medine. Banorët e saj u ndikuan nga ato, i zbatuan në jetët e tyre publike dhe private, edhe pse ato ishin udhëzime për tërë umetin mirëpo shoqëria medinase gjatë periudhës profetike u ndikua nga ato dhe bënë një ndryshim para të tjerëve dhe kontribuan në zhvillimin shëndetësor që u inicua me ardhjen e Profetit në Medine. Ndikimi i tij vazhdon të jetë edhe në ditët e sotme dhe derisa te këtë jetë.

### *Zhvillimi ekonomik:*

Profeti ishte produktiv qysh në fëmijëri. Ai ishte shembëlltyrë në këtë drejtim. Banorëve të Mekes ua ruante dhent që të fitonte dhe t'i ndihmonte axhës së tij Ebu Talibit për të ushqyer fëmijët e tij. Ai kishte thënë: “S'ka dërguar Allahu

---

<sup>1</sup> Ibën Hisham, Sire nebevije 3/238

<sup>2</sup> Sahih Muslim 1/152

pejgamber e që s'ka ruajtur dhen. Të pranishmit e pyetën: edhe ti o i dërguar i Allahut? Tha: edhe unë i kam ruajtur për mekasit për ca kiratë<sup>1,2</sup>

Kur u rrit Profeti dhe u bë burrë, Hadixhe bint Huvejlid, Allahu qoftë i kënaqur prej saj, e punësoi që të tregtonte për të, andaj ai bëri disa udhëtime për tregti.

Profeti nxiste në punë dhe produktivitet: “s'ka ngrënë ushqim më të mirë askush se ushqimin që e ka fituar nga dora e tij. Profeti i Allahut Davudi ushqej me atë që e fitonte me dorën e tij.”<sup>3</sup> Ai u sillte shokëve të tij shembuj të profetëve produktiv, andaj kishte thënë: “Zekerija ishte zdrukthtar”<sup>4</sup>

Sjellja e profetit me punëtorët në Medine ishte inkurajuese. Ai i përgjigjej ftesës së rrobaqepsit<sup>5</sup>, të birin Ibrahimin e çoi tek bashkëshortja e një farkëtari për mëndje<sup>6</sup>. Kjo sejlje dhe të tjera ndikuan në ndryshimin e perceptimit të medinasve dhe arabëve tjerë kundrejt disa zanateve të cilat i nënçmonin siç ishte farkëtaria dhe të tjera.<sup>7</sup>

Ligjet e ndryshme islame të cilat i zbatoi Profeti kontribuan në rritjen e prodhimit në Medine dhe zhvillimin ekonomik në shumë sfera, prej tyre:

#### *Zhvillimi i tregtisë:*

Kur erdhi Profeti në Medine, tregtia ishte në duart e hebrenjëve të cilët dominon në tregjet e saj, veçanërisht tregu i Benu Kajnukas<sup>8</sup> i njohur sipas emrit të tyre, tregu më i njohur i Medines. Kur Profeti u shpërngul në Medine, ishte kujdesur që muslimanët të mos humbisnin në tregje ekonominë medinase.

---

<sup>1</sup> Pjesë e dinarit, Ibn Haxher, Fet-hul Bari 10/5

<sup>2</sup> Buhariu

<sup>3</sup> Buhariu

<sup>4</sup> Ibn Maxheh 2/773

<sup>5</sup> Buhariu

<sup>6</sup> Ibn Haxher, El-Isabeh, 4/98

<sup>7</sup> Abdulaziz El-Umerij, Elhiref ue sinaat fil Hixhaz fil asrin-nebevij, fq: 43

<sup>8</sup> Amër b. Shebeh, Tarih El-Medineh, 1/304

Tregu i Benu Kajnukas ishte më kryesori në periudhën parailsame. Aty zhvilloinin aktivitete tregtare edhe disa arabë nga fisi Eus dhe Hazrexh megjithëse ekzistonin tregje të vogla të tyre siç ishte tregu Mezahim.<sup>1</sup>

Medineja veçohej me prodhime bujqësore prej hurmave dhe të tjera. Arabët nomadë vinin aty për të blerë këto hurma. Po ashtu është mekasit shkonin në Medinë për të blerë hurma, prodhime të tjera bujqësore dhe disa prodhime të thjeshta industriale. Hebrenjët kishin në dorë kapitalin dhe njerëzve ju jepnin borxh me kamatë. Pasuria që kishin ju ndihmonte të dominonin dhe të kishin fjalën e tyre.

Edhe Eusi dhe Hazrexhi kishin rol në ekonominë medinase, mirëpo roli i tyre bujqësor ishte më i fuqishëm në tregti.

Kur u shpërngul Profeti dhe shokët e tij në Medine, shumica e muhaxhirëve e mes tyre edhe disa kurejshit kishin prirje për tregti. Shumë prej tyre, posa arritën në Medine pyetën për tregun, blenë – shitën, duke kërkuar kështu furnizimin. Njëri prej tyre ishte Abdurahman b. Auf dhe Omer b. Hatab.<sup>2</sup>

Profeti vuri re dominimin e hebrenjëve në tregtinë medinase nëpërmjet dominimit të tyre në tregun Benu Kajnukaë, kështu, Medines i bëri një treg tjetër larg dominimit hebre. Ai caktoi vendin e tregut në Bekinë e Ibën Zubejrit dhe tha: ky është tregu juaj. Kjo punë i mlllefosi hebrenjtë dhe kuptuan rrezikun dhe konkurrencën e tij. Aty erdhi Kab b. Eshref, hyri në treg dhe theu disa degë që mbulonin tendën. Profeti tha: “s’do mend që do ta transferoj tregun në një vend që i mlllefos më shumë” – dhe e transferoi në tregun e Medines, pastaj tha: “ky është tregu juaj, të mos shuhet, të mos ngushtohet dhe të mos merret (pë ata që punojnë aty) tatim”<sup>3</sup>

Profeti ndaloi që t’i merret pagesë ndonjërit që do të punonte në tregun e ri të Medines dhe kjo bëri që tregu të lulëzojë dhe të vizitohet shumë. Zgjedhja e Profetit ishte shumë e suksesshme ngase ishte si hyrje e Medines për ata që vinin nga ana e Shamit, Mekes, Jemenit apo nga vendet e fiseve fqinje. Ky treg i

---

<sup>1</sup> Es-Semhudij, Uefaul-uevfa, 4/1306

<sup>2</sup> Sahih Buhari

<sup>3</sup> Es-Semhudij, Uefaul uefa, 2/749



muslimanëve pranonte grupe tregtarësh posa arrinin në Medine dhe para se të arrinin në tregun Benu Kajnukaë, gjë që i mlléfosi hebrenjët. Nuk ka dyshim se kjo vepër kishte një rol të madh në lulëzimin e tregtisë, shtiblerjes mes muslimanëve dhe të tjerëve dhe zhvillimin e aspektit ekonomik të tyre.

Tregtia rritej gradualisht në tregun e muslimanëve si rezultat i aktiviteteve të muhaxhirëve shumica e të cilëve ishin nga kurejshët e këta të fundit ishin tregtarë në esencë. Ebu Bekri, Omeri, Othmani merreshin me shitblerje. Othmani, Talha b. Ubejdullah shitnin drith në tregun e Medines. Profeti kalonte kah shitësit në tregun e Medines, blente prej tyre dhe ua tërhiqte vërejtjen që të mos mashtrojnë. Sahabët merrnin pjesë në udhëtimet tregtare nga Medineja në Sham gjatw kohws kur ishte profeti ishte gjallë.<sup>1</sup>

#### *Organizimi i shtetit dhe caktimi i përgjegjësiwe:*

Vendet arabe, në veçanti Hixhazi dhe Nexhdi, kanë qenë larg nga organizimi politik dhe administrativ. Ato u nënshtroheshin zakoneve dhe fiseve që administronin veten pa strategji, pa politikë apo shtet të caktuar në të shumtën e rasteve. Nuk është njohur në Mekë ndonjë udhëheqësi me peshë apo administratë. As në Medinë s'ka pasur diçka të tillë. Ata udhëhiqeshin sipas sistemit fisnor dhe zakonor, edhe pse ishin banorë të qyteteve ata nuk kishin organizim dhe administratë të caktuar derisa hynë nën udhëheqjen e Profetit.

Administrimi i pushtetit dhe organizimi i tij është një nga shenjat më të dukshme me të cilat erdhi Kurani. Allahu i madhëruar thotë: “All-llahu ju urdhëron që t'u jepni amanetin të zotëve të tyre dhe kur të gjykoni, ju urdhëron të gjykoni me të drejt mes njerëzve. Sa e mirë është kjo që ju këshillon. All-llahu dëgjon dhe sheh si veproni. O ju që besuat, bindjuni All-llahut, respektoni të dërguarin dhe përgjegjësit nga ju. Nëse nuk pajtoheni për ndonjë çështje, atëherë parashtrojeni atë te All-llahu (te libri i Tij) dhe te i dërguari, po qe se i besoni All-llahut dhe ditës së fundit. Kjo është më e dobishmja dhe përfundimi më i mirë.” (Nisa: 58,59) po ashtu ka thënë: “Ne i dërguam të dërguarit Tanë me dokumente të qarta dhe Ne

---

<sup>1</sup> Ibn Kethir, Es-Sire nebevije, 2/249

zbritëm me ata librin dhe drejtësinë që t'i përmbahen njerëzit të së drejtës. Ne e kemi zbritur edhe hekurin që në të ka forcë të fortë dhe dobi për njerëz, e edhe për t'u ditur tek All-llahu se kush ndihmon Atë (rrugën e Tij) dhe të dërguarit e Tij duke i besuar të fshehtës. S'ka dyshim se All-llahu është i fuqishëm, mbizotërues.” (Hadid: 25)

Profeti ishte kryetari i shtetit, ai emëronte funksionarë dhe nëpunës<sup>1</sup>. Ai ishte i kujdesshëm në administrim dhe rënditjen e përgjegjësive. Që prej Besëlidhjes së Dytë të Akabes, Profeti i organizoi besatarët dhe kërkoi prej tyre të zgjedhin liderët që do të ishin përgjegjës për të tjerët dhe të merrnin urdhëra, udhëzime dhe të përcillnin zbatimin e tyre secili në këndin e vet.

Kjo beslidhje e burrave dhe grave pati një kuptim shumë të veçantë. Është përmendur në Librin e Allahut: “O Pejgamber, kur të vijnë besimtarët që të të japin besën se: nuk do t'i shoqërojnë asnjë send All-llahut; se nuk do të vjedhin; se nuk do të bëjnë kurvëri; se nuk do t'i mbysin fëmijët e tyre; se nuk do të gënjejnë me ndonjë shpifje për (fëmijën e huaj që kanë marrë) se është i tyre; dhe se nuk do të kundërshtojnë në atë që i urdhëron, atëherë prano zotimin e tyre dhe lute All-llahun t'i falë ato, se All-llahu është mëkatfalës dhe mëshirues.” (Mumtehineh: 12)

Urdhërat e Profetit ishin të qarta për caktimin e përgjegjësive në çdo grupim i vogël apo i madh. Ai thoshte: “nuk lejohet të jenë tre vetë në një vend e njërin prej tyre mos ta caktojnë si udhëheqës”<sup>2</sup>

Profeti udhëhiqte edhe çështjet ushtarake të shtetit. Ai edukoi umetin e tij në organizim, renditje të udhëheqësisë, dëgjueshmëri dhe bindje në vepra të mira.

Medineja u bë kryeqytet i shtetit islam. Udhëheqësi real i Medines ishte Profeti. Ai merrej me administrimin e punëve të saj. Kur mungonte, caktonte zëvendës. Dijetarët e jetëshkrimit profetik kanë cekur emrat e zëvendësve të Profetit në Medine për çdo betejë. Prej më të njohurve të cilët Profeti i ngarkoi me

---

<sup>1</sup> Ummalur-Resul alel buldan, Halife b. Hajjat, fq: 60. Abdulaziz El-Umerij, El-vilajetu ala buldan fi asri hulefair-rashidin, fq: 39

<sup>2</sup> Ahmedi në Musned, 2/177

udhëheqjen e Medines në mungesë të tij ishin: Abdullah b. Ummi Mektum<sup>1</sup> të cilin e la zëvendës trembëdhjetë herë<sup>2</sup>: në betejën e Bedrit<sup>3</sup>, ne Hamraul esed dhe beteja tjera<sup>4</sup>. Profeti e linte zëvendës në Medine edhe Othman b. Affanin.<sup>5</sup>

Profeti organizonte udhëheqësit dhe nëpunësit në vilajetet e ndryshme që njiheshin në periudhën profetike dhe ishin nën administratën e Medines, prej tyre: vilajeti i Jemenit dhe Mekes<sup>6</sup>, Taifit dhe Bahrejnit<sup>7</sup>, Umanit<sup>8</sup>.

Profeti - udhëheqësi i shtetit islam shumë shpesh konsultohej me shokët e tij. Atij iu shpall surja Shura (Konsultimi) për t'ia fokusuar këtë parim: “Edhe ata që i përgjigjen thirrjes së Zotit të tyre dhe e falin namazin rregullisht dhe ata që konsultohen mes vete për punë të përbashkëta, e nga ajo që Ne ua japim ata e shpërndajnë” (Shura: 38), “Ti ishe i butë ndaj atyre, ngase All-llahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do shkapërderdheshin prej teje, andaj ti falju atyre dhe kërko ndjesë për ta, e konsultohu me ta në të gjitha çështjet, e kur të vendosësh, atëherë mbështetu në All-llahun, se All-llahu i do ata që mbështeten.” (Ali Imran: 159). Janë vërtetuar konsultimet e shpeshta që i bënte i Dërguari me shokët e tij para se të merrte vendime të rëndësishme, aq sa disa nga shokët e tij u njohën si këshilltarë Të profetit.

### *Drejtësia dhe barabarësia:*

Drejtësia është një parim islam dhe human shumë i rëndësishëm. Ajo drejton çështjet private dhe publike të besimtarit, në veçanti ato që kanë të bëjnë me të tjerët kur ka ndonjë përgjegjësi udhëheqëse ndaj tyre. Drejtësia është një virtyt i lartë që synohet të zbatohet nga sistemet e ndryshme, në çdo kohë dhe vend.

---

<sup>1</sup> Abdullah b. Ummi Mektum, shok i profetit, kureshij, qysh herët pranoi Islamin në Mekë. Ishte nga muhaxhirët e parë. Ai është i verbëri i përmendur në suren Abese. Ra dëshmor në betejën Makdisije (Ibn Haxher, El-Isabeh, 2/525)

<sup>2</sup> El-Isabeh 2/523

<sup>3</sup> Halife b. Hajjat, fq: 96

<sup>4</sup> Ibn Hisham, Sire nebevije, 3/101,102

<sup>5</sup> Sujutij, Tarihul hulefa, 1/148

<sup>6</sup> Taberij, Tarih, 3/126

<sup>7</sup> El-Beladherij, Fet-hul buldan, 90.

<sup>8</sup> Halife b. Hajjat, Tarih, 97.

Allahu i madharuar thotë: “All-llahu urdhëron drejtësi, bamirësi, ndihmë të afërmve, e ndalon nga imoraliteti, nga e neveritura dhe dhuna. Ju këshillon ashtu që të merrni mësim.” (Nahël: 90), “All-llahu ju urdhëron që t'u jepni amanetin të zotëve të tyre dhe kur të gjykoni, ju urdhëron të gjykoni me të drejt mes njerëzve. Sa e mirë është kjo që ju këshillon. All-llahu dëgjon dhe sheh si veproni.” (Nisa: 58), “E për këtë shkak (të përçarjes së tyre), ti thirr dhe përqëndrohu ashtu si të është urdhëruar dhe mos shko pas dëshirave të tyre dhe thuaj: "Unë kam besuar në librat që i shpalli All-llahu, jam urdhëruar të mbaj drejtësi mes jush, All-llahu është Zoti ynë dhe Zoti juaj; Ne kemi përgjegjësinë e veprave tona e ju të veprave tuaja, nuk ka polemikë mes nesh e jush; All-llahu bën tubimin mes nesh dhe vetëm te Ai është përfundimi!"” (Shura:15), “E ti kurrsesi mos e mendo All-llahun si të pakujdesshëm ndaj asaj që veprojnë zullumqarët; Ai vetëm është duke i lënë ata përderisa një ditë në të cilën sytë shtangen (mbesin të hapur). (atë ditë) Ata të ngutur e duke u ngritur kokat e tyre lart, nuk lëvizin sytë e tyre (për të shikuar), e zemrat e tyre janë të zbrazura (nga frika). Dhe ti tërhiqju vërejtjen njerëzve për ditën kur atyre do t'u vijë dënimi, e ata që ishin mizorë thonë: "Zoti ynë! Na jep afat për një kohë të shkurtër t'i përgjigjemi thirrjes Tënde (për besim) dhe t'i pasojmë të dërguarit!" A nuk u betuat ju më parë se për ju nuk ka lëkundje (prej Dunjasë në botën tjetër)?" (Ibrahim: 42-44), “O ju që besuat! Bëhuni plotësisht të vendosur për hir të All-llahut, duke dëshmuar të drejtën, dhe të mos u shtyjë urrejtja ndaj një populli e t'i shmangeni drejtësisë; bëhuni të drejtë, sepse ajo është më afër devotshmërisë. Kini dro All-llahun se All-llahu di hollësisht për atë që veproni.” (Maide:8)

Drejtësia nuk është e veçantë vetëm për gjyqësinë por një drejtim i përgjithshëm për çdo musliman, është esenca e çdo administrimi. Çdonjëri që ka përgjegjësi administrative duhet të jetë i drejtë me punëtorët e tij, me ata që kanë lidhje me punën dhe me ata që kanë interese me punën e tij. Drejtësia kërkohet nga çdo njeri madje edhe në administrimin e familjes së tij dhe çështjet private, e të mos flasim kur ndonjëri ka post që ka të bëjë me publikun apo me dikë privat.

Profeti tërhoqte vërejtjen nga padrejtësia: “ruhuni nga padrejtësia sepse ajo nënkupton errësira të shumta”<sup>1</sup>

Ai urdhëronte të zbatohet drejtësia mbi të dobëtin dhe të fortin dhe tërhoqte vërejtjen nga devijimi në këtë aspekt: “para jush u shkatërruan popuj, ngase kur vidhte në mesin e tyre i pasuri, e toleronin, ndërsa kur vidhte i varfëri, ia jepnin dënimin. Pasha Allahun, sikur Fatimja, e bija e Muhamedit të vidhte, do t’ia prisja dorën”<sup>2</sup>

Profeti ushtronte detyrën e gjykatësit mes njerëzve<sup>3</sup>, me vëmendje ndiqte drejtësinë, kishte dro nga mashtrimet që bënin të hasmuarit ndaj njëri tjetrit, tërhoqte vërejtjen nga shkelja e të drejtave nëpërmjet vendimeve gjyqësore, për këtë “kishte dëgjuar një zënkë para shtëpisë së tij, doli dhe ju tha: unë jam njeri, më vijnë të hasmuarit dhe ndodh që ndonjëri të jetë më orator, mendoj që është në të drejtë dhe gjykoj në favor të tij, prandaj, nëse gjykoj në favor të dikujt (gabimisht), ajo është një copë zjarri, le ta merr ose ta lerë”<sup>4</sup>

Profeti gjykonte mes të gjithë njerëzve, punonte që secili t’i arrijw të drejtat e veta, qofshin ata muslimanë apo jomuslimanë. Ai shpejgonte etikën e gjyqtarëve dhe të hasmuarve, tërhoqte vërejtjen nga gënjeshttrat gjatë padive apo betimet për të marrë atë që s’ju përkiste. Abdullah b. Mesudi përcjellw se Profeti kishte thënë: “kush betohet dhe gënjen për të përvetësuar një pasuri të muslimanit, do ta takojë Allahun të hidhëruar”<sup>5</sup>. Lidhur me këtë ka zbritur ajeti: “Ata që për një vlerë të paktë e shesin besën e dhënë All-llahut, ndryshojnë edhe zotimet e tyre, të tillët nuk kanë pjesë (mëshirë) në botën tjetër, dhe në ditën e kijametit All-llahu nuk u flet atyre, nuk i shikon ata dhe nuk i pastron (prej barrës së gabimeve), ata kanë një dënim të dhembshëm.” (Ali Imran: 77), “largohuni nga ndytësitë e idhujve dhe largohuni fjalës shpifëse” (Haxh: 30)

---

<sup>1</sup> Buhariu 3/99

<sup>2</sup> Buhariu, hadithi nr: 3733

<sup>3</sup> Për literaturë shtesë rreth kësaj çështjeje: Abdullah b. Muhamed b. Ferexh El-Malikij El-Kurtubij, Ekdijetu Resulillah.

<sup>4</sup> Buhariu, hadithi nr: 2458

<sup>5</sup> Buhariu, hadithi nr: 2416

Udhëzimet e tij për barabarësi mes të hasmuarve ishin të qarta, të mos gjykohej me epsh por të ndiqej rruga e qartë ligjore: “paddingritësi duhet të sjellë dëshmi ndërsa betimi është për atë që mohon (padinë)”<sup>1</sup>

Kurani kërkoi që të zbatohet drejtësia pa ndjekur epshin edhe nëse e vërteta është kundër njerzve më të shtrenjtë, madje edhe nëse është kundër vetes: “O ju që besuat, vazhdimisht të jeni dëshmues të drejtë për hirë të All-llahut edhe nëse është kundër (interesit) vetvetes suaj, kundër prindërve ose kundër të afërmve, le të jetë ai (për të cilin dëshmohet) pasanik ose varfnjak, pse All-llahu di më mirë për ta. Mos ndiqni pra emocionin e t’i shmangeni drejtësisë. Nëse shtrëmbëroni ose tërhiqeni, All-llahu hollësisht di ç’ka punoni.” (Nisa: 135)

Në hadith kudsij është cekur: “o robërit e Mi, unë ia ndalova Vetes padrejtësinë dhe e bëra të ndaluar atë mes jush, prandaj mos i bëni njëri tjetrit padrejtësi”<sup>2</sup>

Profeti tërhiqte vërejtjen nga gjykatësit kriminelë, ai thoshte: “gjykatësit ndahen në tre grupe, dy prej tyre shkojnë në zjarr ndërsa një në xhenet. Ai që nuk gjykon sipas drejtësisë me vetëdije, ai është në zjarr. Ai që është injorant dhe humb të drejtat e njerëzve është në zjarr. Gjykatësi i cili gjykon me drejtësi, ai është në xhenet.”<sup>3</sup>

Islami ndaloi ryshfetin i cili nxit në padrejtësi, shkeljen e të drejtavë të njerëzve dhe ndikon tek gjykatësit dhe pushtetarët. Ai tha: “Allahu e ka mallkuar atë që jep ryshfet, atë që e merr dhe atë që e mban lidhjen”<sup>4</sup>

Gjyqësori ishte i përgjithshëm në shoqërinë islame. Ai zbatohet në shoqërinë medinase ku përfshiheshin muslimanët dhe të tjerët. Drejtësia është një kërkesë e përgjithshme, me muslimanë dhe të tjerë, Allahu i madhëruar thotë: “Janë ata që i përgjigjen të pavërtetës dhe hanë shumë haramin (ryshfetin). Në qoftë se vijnë te ti (për ndonjë gjykim), gjyko mes tyre ose hiqju tyre. Nëse prapsesh prej tyre (nuk gjykon), ata nuk mund të sjellin ty kurrfarë dëmi. Po nëse gjykon mes tyre, gjyko drejtë; All-llahu i do të drejtë.” (Maide: 42)

---

<sup>1</sup> Buahriu, 3/146

<sup>2</sup> Muslimi 8/17

<sup>3</sup> Sunen Tirmidhij, hadithi nr: 1322

<sup>4</sup> Ahmed: 2/164

Profeti ndërmori të gjitha hapat për vënien e drejtësisë në zbatim. Emëroi gjykatës në vendet larg Medines, dërgonte shokët e tij të gjykonin në zënkat mes njerëzve dhe ju jepte udhëzime<sup>1</sup>. Nuk kishte mbetur vend që ishte pjesë e shtetit të Profetit që nuk ishte emruar udheheqës dhe gjykatës që do zbatonin drejtësinë mes njerëzve. Mbase, kodeksi më i njohur botëror në gjyqësi mund të jetë shkresa e Omer b. Hatabit dërguar Ebu Musa El-Esh'ariut<sup>2</sup> dhe pa dyshim Omeri ato rregulla i mori nga ajo që kishte mësuar nga Profeti rreth çështjeve të gjyqësisë dhe drejtësisë.<sup>3</sup>

Nuk ka dyshim që rregullsia e jetës dhe paqes në çdo shoqëri njerëzore nuk mund të arrihet përpos me sistem, ligje dhe legjislacion të qartë para të cilit të gjithë janë të barabartë, ekzistimi referencës gjyqësore për ruajtjen e të drejtave dhe fuqisë që ndihmon në marrjen e të drejtave nda çdokush, pengimin e padrejtësisë dhe zbatimin e dispozitave gjyqësore. Kjo gjë i motivon të gjithë të jenë lojal dhe mbështetës të këtij sistemi të drejtë që garanton të drejtat, ndihmon për të pasur një jetë dinjitoze, produktivitet real, larg vjedhjes, nëpërkëmbjes së pasurisë së njerëzve, nderit dhe jetëve të tyre.

Në këtë mënyrë, Profeti ngriti drejtësinë në shoqërinë islame, me udhëzime hyjnore dhe praktika profetike, në Medine dhe vendet tjera të Gadishullit Arabik që ishin nën administrimin e tij. Ky sistem u bë shembulltyrë për shtetet islame dhe shoqëritë e tyre ku shtohet siguria dhe besimi i tyre saherë që ndiqnin atë apo shkeleshin të drejtat saherë që largoheshin.

Shkencëtarët dhe dijetarët e Fikhut kanë shkruar aq shumë në këtë drejtim sa që nuk mund të përkufizohet tërë ajo trashëgimi shkencore, shariatike, e drejtë, administrative, ligjore dhe politike, por duhet të shikohet nga pikëpamja civilizuese<sup>4</sup>. Shumë prej bijëve të këtij umeti nuk e njohin këtë trashëgimi ndërsa një numër i madh shtirret se nuk e njeh prej liderëve dhe vendimmarrësve, prandaj humbën dhe i humbën të tjerët.

---

<sup>1</sup> El-Maverdij, El-Ahkam Es-Sultanije, fq: 67

<sup>2</sup> Ibn Kajimi e komentoi shkresën e Omerit dërguar Ebu Musa El-Esh'ariut në librin e tij 'l'lamul muvekiin' në më tepër se 450 faqe. Shiko l'lam el-muvekiin, 1/86

<sup>3</sup> Ibn Kajim, l'lamuk muvekiin, 1/85,86

<sup>4</sup> Muhamed Fet-hi Uthman, Min usulil fikris-sijasil-islamij

### *Vendosja e sigurisë dhe paqes:*

Ruajtja e sigurisë është një nga nevojat më të rëndësishme njerëzore, është domosdoshmëri në çdo shoqëri. Kur u paraqit Profeti, vendet arabe jetonin në një rrëmujë për sa i përkiste sigurisë. I forti hante të dobëtin, njerëzit e kishin të pamundur të udhëtonin dhe të mbronin veten përpos nëse kishin fuqi dhe aleanca që rregullonin sigurinë. Nuk ekzistonte sistem apo legjislacion që mbronin njerëzit nga sulmet e të tjerëve.

Siguria ishte për të gjithë njerëzit që prej daljes në skenë të shtetit islam në Medine dhe një nga qëllimet kryesore të tij. Ai bashkoi mes pengimit të krimit, sanksionimit të kriminelit, mbrotjen e të drejtave, sistemit të drejtësisë dhe përhapjen e sigurisë. Kjo është një ndër kërkesat më të rëndësishme të njeriut, pas fesë dhe monoteizmit dhe me të është furnizimi. Të gjitha këto janë përmendur shkurtimisht në fjalët e Allahut: “Pra, le ta adhurojnë Zotin e kësaj shtëpie, i cili i ushqeu pas urisë dhe i siguroi prej çdo frike!” (Kurejsh: 3,4)

Pra, monoteizmi, furnizimi dheiguria janë përmendur bashkërisht në këtë mrekulli hyjnore, të lidhura me Shtëpinë e Allahut dhe kiblen e muslimanëve, si simbol për vendin, sistemin dhe fenë në të njëjtën kohë.

Disa ajete kuranore përkujtojnë njerëzit për rëndësinë e sigurisë së bashku me furnizimin: “I cili i ushqeu pas urisë dhe i siguroi prej çdo frike!” (Krejsht: 4), “Atyre nga mesi juaj të cilët besuan dhe bënë vepra të mira, All-llahu u premtoi se do t’i bëjë zotërues në atë tokë ashtu si i pat bërë zotërues ata që ishin para tyre dhe fenë të cilën Ai e pëlqeu për ta, do ta forcojë, e në vend të frikës Ai do t’ju dhurojë siguri. Ata më adhurojnë Mua e nuk më shoqërojnë asgjë. E kush edhe pas kësaj mohon, të tillët janë ata më të prishurit.” (Nur: 55), “Aty ka shenja të qarta: vendi i Ibrahimit, dhe kush hyn në te, ai është i sigurt. Për hir të All-llahut, vizita e shtëpisë (Qabes) është obligim për atë që ka mundësi udhëtimit te ajo, e kush nuk e beson (ai nuk e viziton); All-llahu nuk është i nevojshëm për (ibadetin që e bëjnë) njerëzit.” (Ali Imran: 97), “(Përkujto) Kur Ibrahim tha: "Zoti im! Bëje këtë qytet të sigurt dhe më mbro mua e bijtë e mi nga adhurimi i idhujve (statuja



gurësh).” (Ibrahim: 35), “Ata që besuan dhe besimin e tyre nuk e ngatërruan me besim të kotë, atyre u takon të jenë të sigurt dhe ata janë në rrugë të drejtë.” (En’am: 82)

Allahu i madhëruar e sqaroi rëndësinë e sigurisë në jetën e popujve nëpërmjet rrëfimeve për profetët. Kur flet për popullin e Salihit, thotë: “A do të mbeteni në këtë që jeni (përgjithmonë) të sigurtë?” (Shuara:146), ndërsa në përgjithësi për popujt dhe vendet thotë: “A mos u siguruan banorët e fshatrave nga dënimi jonë paradite, kur ata ishin duke luajtur? A mos u siguruan ata prej ndëshkimit të All-llahut? Nuk sigurohet kush prej frikës së ndëshkimit të All-llahut pos njerëzve të humbur.” (A’raf: 98,99), “All-llahu sjell si shembull një fshat (vendbanim) që ishte i sigurt dhe i qetë, të cilit i vinte furnizimi nga të gjitha anët me bollëk, kurse ata (banorët) i përbuzën të mirat e All-llahut. Atëherë All-llahu, për shkak të sjelljes së tyre, ua veshi petkun (ua ngjeshi) e urisë dhe të frikës.” (Nahël: 112)

Profeti në më shumë se një rast i përgëzonte shokët e tij se siguria do të mbretërojë me këtë fe, prej tyre: “pasha Allahun, shumë shpejtë do të dëgjoni për një grua që do të niset me devenë e saj nga Kadisija e të shkojë të vizitojë këtë xhami (Qaben), nuk do frikohet nga askush pos Allahut”<sup>1</sup> po ashtu ka thënë: “do ta plotësojë Allahu këtë fe derisa udhëtari të ecë nga San’a deri në Hadremeut, nuk do t’i frikohet askujt përpos Allahut dhe ujkut për dhentë e tij”<sup>2</sup>

Paqa dhe siguria mes njerëzve ishin nga qëllimet kryesore të Islamit dhe si rrjedhojë duheshte të luftohej frika dhe gjërat që e sjellin atë, për këtë, qëllimi i pushtetit në krye të të cilit qe Profeti ishte realizimi i sigurisë.

Profeti vëndonte theksin në fjalët dhe fjalimet e tij mbi paqen dhe sigurinë mes njerëzve dhe mosshkeljen e të drejtave të tyre. Nga fjalët më të njohura të tij në haxhin lamtumirës ishin: “cili muaj është më i shenjtë? Thanë: ky mauji në të cilin ndodhemi. E cili vend që njihni është më i shenjti? Thanë: ky vendi në të cilin ndodhemi. Cila ditë është është më e shenjta? Thanë: kjo ditë në të cilën jemi. Tha: Allahu i madhëruar i shenjtëroi gjaqet, pasuritë dhe nderet tuaja mes jush përveç me të drejtën (e ligjit) ashtu siç shenjtëroi këtë ditë, këtë vend dhe këtë

---

<sup>1</sup> Taberiu, Tarih, 3/150

<sup>2</sup> Buhariu, 3/238

muaj! Vini re, a e kumtova (tre herë)? Të gjithë u përgjigjën: po. Tha: mjerë për ju, mos u ktheni pas meje në mosbesimtarë, që presin qafat e njëri tjetrit.”<sup>1</sup>

Profeti kishte vërtetuar rëndësinë e sigurisë në jetën e njeriut: “kush gdhinë nga ju i sigurt në gjirin familjar, i shëndoshë në trupin e tij dhe posedon kafshatën e ditës është sikur të kishte tërë dynjanë.”<sup>2</sup> Po ashtu kishte thënë: “nuk i lejohet muslimanit ta frikësojë muslimanin.”<sup>3</sup> Ndërsa nga lutjet e tij ishte: “o Allah, mi mbulo të metat dhe më jep siguri nga frika!”<sup>4</sup>

Shteti islam në Medine dha kontributin e tij në përhapjen e sigurisë dhe paqes mes njerëzve<sup>5</sup>, muslimanë apo jomuslimanë. Kjo ishte shtylla e Kartës së Medines midis Profetit dhe popullatës dhe fiseve medinase. Ishte mbrojtja e përbashkët, përhapja e paqes dhe mosmbështetja e atij që shkaktonte frikë mes banorëve të saj, atyre që prishnin rendin dhe të ngjashëm.<sup>6</sup>

Profeti ndiqte personalisht sigurinë e Medines dhe mirëqenien e banorëve të saj si dhe atyre që vinin aty, zbatonte kodin penal mbi kriminelët që bënin çregullime, derdhnin gjakun dhe prishnin sigurinë dhe paqen.

Buhariu në Sahihun e tij shkroi një kapitull me titullin “Veprat penale, nga cilat vepra penale duhet pasur kujdes”. Aty përmendi shumë nënkapituj, prej tyre: “penalizohet edhe aristokrati edhe i rëndomti”<sup>7</sup>. Një nënkapitull tjetër e titulloi: “nuk preferohet ndërmjetësimi për të hequr penalizimin që ka arritur tek udhëheqësi”<sup>8</sup> dhe si argument solli transmetimin e Aishes e cila thotë: “kurejshët u brengosën me rastin e gruas mahzumije e cila kishte vjerdhur. Thanë: kush mund të ndërmjetësojë te Profeti për të? E kush ka guximin për këtë përveç Usame b. Zejdit, dashamirit të Profetit – thanë sërish. Usameja intervenoi te Profeti ndërsa ai i tha: “Usame! A intervenon për të zhvlerësuar një ligj të Allahut?! Pastaj mbajti një fjalim deh tha: “para jush u shkatërruan popuj, ngase

---

<sup>1</sup> Buhariu, hadithi nr: 6785

<sup>2</sup> Tirmidhiu, hadithi nr: 2346

<sup>3</sup> Ahmedi në Musned, 5/262

<sup>4</sup> Ahmedi në Musned, 2/25

<sup>5</sup> Abdullah Turkij, El-emnu fi hajatin-nas ue ehemijetuhu fil Islam”

<sup>6</sup> Shiko: Karta e Medines, në këtë libër.

<sup>7</sup> Buhari 8/16

<sup>8</sup> Buhari 8/16

kur vidhte në mesin e tyre i pasuri, e toleronin, ndërsa kur vidhte i varfëri, ia jepnin dënimin. Pasha Allahun, sikur Fatimja, e bija e Muhamedit të vidhte, do t'ia prisja dorën”<sup>1</sup>

Buhariu në Sahihun e tij vuri një titull me ajetin: “Vjedhësit dhe vjedhëses prejuani duart, si shpagim i veprës që bënë, (kjo masë është) dënim nga All-llahu. All-llahu është i fuqishëm, ligdhënës i urtë.” (Maide: 38) Profeti e zbatoi dënimin e vjedhjes mbi gruan mahzumije. Atë nuk e pengoi autoriteti i saj as ndërmjetësimi i Usame b. Zejdit dhe të tjerë nga autoritetet e mekës për të zbatuar ligjin e sheriatit mbi të. Vihet re që ai ka zbatuar më shumë se një herë në jetën e tij ligjin kundër vjedhjes.<sup>2</sup>

Ligji kundër vjedhjes kishte një rol të madh në sigurinë e njerëzve dhe mbrotjen e pasurive të tyre si dhe në frikësimin e vjedhësve, kështu që vjedhja u zbeh shumë aq sa gati nuk ekzistonte në periudhën profetike. Nuk ka dyshim se aty ku zbatohet ligji islam kundër vjedhjes, vjedhja do të zvogëlohet dhe njerëzit do të kenë siguri për pasuritë e tyre.

Urdhëri i qartë për ‘kisas’ (dënimi në masë të njejtë) ndikoi që njerëzit të mos mendonin për vrasje dhe derdhjen e gjakut ngase e dinin që gjaqet e tyre do derdheshin dhe se dënimi i njejtë i priste. Në këtë mënyrë gjaqet e njerëzve dhe jetët e tyre ruheshin, siç thotë Allahu i madhëruar: “O ju të zotët e mendjes, kjo masë e dënimit është jetë për ju, ashtu që të ruheni (nga mbytja e njëri-tjetrit).” (Bekare: 179)

Është i njohur edhe denimi për terror që është përmendur në ajetin kuranor: “Dënimi i atyre që luftojnë (kundërshtojnë) All-llahun dhe të dërguarin e Tij dhe bëjnë shkatërrime në tokë, nuk është tjetër vetëm se të mbyten ose të gozhdohen, ose (të gjymtohen), t'u priten duart dhe këmbët e tyre të anëve të kundërta, ose të dëbohen nga vendi. Kjo (masë ndëshkuese) është poshtërim për ta në Dunja, dhe në botën tjetër ata do të kenë dënim të madh. Përveç atyre që janë penduar para se t'i kapni. E, dini pra se All-llahu bën falje të madhe, është mëshirues.” (Maide: 33,34)

---

<sup>1</sup> Buhariu: 8/16

<sup>2</sup> Buhari: 8/15

Profeti e njihje nevojën e njerëzve për siguri, edhe armiqtë e tij u ndien të sigurtë nga ai kur hyri në Mekë si çlirimtar duke bërë publike që çdokush që hyn në shtëpinë e Ebu Sufjanit është i sigurt, çdokush që mbyllet në shtëpinë e tij është i sigurt, çdo kush që hyn në xhami është i sigurt.

Profeti e kuptonte mirë rëndësinë e sigurisë në jetën e njerëzve, për këtë, prej gjërave të para që u përkujtuan njerëzit pas çlirimit të Mekes ishte ndalimi i derdhjes së gjakut.<sup>1</sup>

### *Ndërtimi i etikës dhe moralit<sup>2</sup>*

Shoqëritë njerëzore në përgjithësi dhe shoqëria arabe në veçanti kishin degjeneruar vlerat morale, i bënë keq njëri tjetrit dhe nënçmonin njëri tjetrin.<sup>3</sup>

Tentimet e Profetit për të ndryshuar shoqërinë mekase nga Brenda ishin të fuqishme dhe serioze. Ai tentoi të përhap Islamin dhe atë që lidhej me të sikur: ligjet, ndërtimi etik, moral, lidhjet humane, marrëdhëniet dashamirëse ndërmjet individëve të shoqërisë në përgjithësi, duke filluar me të afërmit, baballarët, fëmijët në përputhshmëri mes fesë, shoqërisë dhe moralit. Kurejshitet u treguan të inatosur dhe morën qëndrim kundërshtues. Ata e luftuan Profetin, e dëmtuan atë dhe shokët e tij. Kjo bëri që Profeti të kërkonte një vend tjetër për të ngritur një shoqëri të dalluar me etikën dhe moralin e saj. Kështu ndodhi shpërngulja në Medine që solli nismën e ndërtimit të shoqërisë islame, humane dhe besimtare. Muhaxhirët u vendosën atje, u afruan, u lidhën dhe u vëllazëruan me ensarët. Sistemi i vëllazërimit që ngjau në Medine nxori në pah thesaret e një shoqërie të pastër e të vëllazëruar, siç thotë Allahu: “Edhe ata që përgatitën vendin (Medinen) dhe besimin para tyre, i duan ata që shpërnguleshin tek ata dhe nuk ndiejnë në gjoksat e tyre ndonjë nevojë (për zili a tjetër) nga ajo që u jepej atyre (muhaxhirëve), madje edhe sikur të kishin vetë nevojë për te, ata u jepnin

---

<sup>1</sup> Ibn Hisham, Sire, 4/415

<sup>2</sup> Këtë temë më bukur e ka trajtuar Buhariu në Sahihun e tij në kapitullin e etikës. Aty ka përmendur tema të ndryshme të moralit sikur: lidhjet farefisnore, tolerancën, raportin me fqinjin, të mjerin, familjen dhe tjerë në më shumë se 128 nënkapituj.

<sup>3</sup> Për studim më të zgjeruar në këtë temë konsultto: Ahmed b. Abdulaziz b. Kasim El-Haddad: Ahlakun-nebij fil Kur’ani ues-sunneh.

përparësi atyre para vetvetes. Kush është i ruajtur prej lakmisë së vet, të tillët janë të shpëtuar.” (Hashër: 9)

Ndërtimi i bashkimit dhe vëllazërimit ishte për gjeneratën e sahabëve dhe për gjeneratat e umetit pas tyre, Allahu thotë: “Edhe ata që kanë ardhur pas tyre e thonë: "Zoti ynë, falna neve dhe vëllazërit tanë që para nesh u pajisën me besim dhe mos lejo në zemrat tona farë urrejtjeje ndaj atyre që besuan. Zoti ynë Ti je i butë, mëshirues!"” (Hashër: 10)

Pastrimi i shpirtave dhe ngritja e moralit ka qenë esenca e thirrjes së Profetit, Allahu i madhëruar thotë: “(Sikurse plotësova mirësinë Time ndaj jush) Ashtu siç dërguam nga gjiu i juaj të dërguar t'u lexojë ajetet Tona, t'ju pastrojë, e t'ju mësojë librin dhe traditën, e edhe t'ju mësojë atë që nuk e dinit.” (Bekare: 151), “Ai është që arabëve të pashkolluar u dërgoi Pejgamberin nga mesi i tyre që t'ua lexojë ajetet e Tij, t'i pastrojë ata, t'ua mësojë librin dhe sheriatin, edhe pse më parë ata ishin në një humbje të dukshme.” (Xhuma: 2)

Ligjet islame erdhën për të ndërtuar lidhje të mira ndërmjet individëve të shoqërisë<sup>1</sup> dhe brenda familjes, Profeti tha: “mirësjellja është morali i mirë”<sup>2</sup>, po ashtu tha: “më të mirët nga ju janë më të moralshmit”<sup>3</sup>

Islami i dha rëndësi rregullimit të raporteve të fëmijve me prindërit e tyre dhe prindërit me fëmijët e tyre. Urdhëri hyjnor për mirësjellje nda prindërve nënkuptonte përmirësimin e raporteve mes një gjeneratë dhe tjetrës, përhapjen e mëshirës dhe raporteve të ndërsjella. Mirësjellja ndaj prindërve është përmendur krahas bindshmërisë ndaj Allahut në Kuran: “Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë që të mos adhuroni tjetër pos Tij, që të silleni në mënyrë bamirëse ndaj prindërve. Nëse njërin prej tyre, ose që të dy, i ka kapur pleqëria pranë kujdesit tënd, atëherë mos u thuaj atyre as "of - oh", as mos u bë i vrazhdë ndaj tyre, po atyre thuaju fjalë të mira (të buta, respektuese). Dhe në shenjë mëshire shtrihe pranë tyre krahu përulës e respektues dhe thuaj: "Zoti im! Mëshiroi ata të dy, sikurse më edukuan mua kur isha i vogël".” (Isra: 23,24)

---

<sup>1</sup> Muhamed Abdulaziz El-Haulij, El-Edeb en-nebevij, idhat baligah ue hikem baligah

<sup>2</sup> Ahmedi në Musned, 2/250

<sup>3</sup> Buhariu 7/82

Kurani i dha rëndësi edhe raportit të mirë me farefisën: “Dhe jepi çdo të afërmi të drejtën që i takon, edhe të varfërit, edhe atij në kurbet, po mos shpenzo tepër e pa rrugë.” (Isra: 26)

Profeti ishte në shkallën më të lartë të moralit, siç e përshkroi Allahu i madhëruar: “Vërtet, ti je në një shkallë të lartë të moralit!” (Kalem: 4) Ndërsa Allahu urdhëroi njerëzit të marrin shembull Profetin: “Ju e kishit shembullin më të lartë në të dërguarin e All-llahut, kuptohet, ai që shpreson në shpërblimin e All-llahut në botën jetër, ai që atë shpresë e shoqëron duke e përmendur shumë shpesh All-llahun.” (Ahzab: 21), ndërsa vetë profeti thoshte: “jam dërguar që t’i plotësoj virtytet e moralit”<sup>1</sup>

Profeti ishte modest, vizitonte të sëmurët, përcillte xhenazet, i përgjigjej ftesave, urrente të ngriten në këmbë për të, ishte modest me të vjetrit dhe të rinjtë. Kur vinte ndonjë i huaj, nuk e dallonte atë në mesin e shokëve të tij nga mënyra si ulej. Ishte bujar dhe urdhëronte në bujari, fisnik dhe urdhëronte në fisnikëri, i ndershëm dhe urdhëronte në ndershmëri dhe pavarësi nga njerëzit, trim dhe mendar dhe urdhëronte në urtësi, i butë dhe urdhëronte në sjellje me butësi, i pastër dhe urdhëronte në pastërti. Mbi të gjitha ishte i edukuar me Allahun e madhërishtëm duke u nisur nga monoteizmi dhe kënaqësia e të qenit rob i Tij, mendimi i mirë për Zotin e tij, të mbështeturit në Të, frika nga Ai, të kënaqurit me caktimin e Tij, varja e shpresave për Të, devotshmëria dhe frikërespekti në vetmi dhe në publikë, përmendja, falenderimi dhe adhurimi i mirë: “E, besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, të cilëve kur përmendet All-llahu u rrëqethen zemrat e tyre, të cilëve kur u lexohen ajetet e Tij u shtohet besimi, dhe që janë të mbështetur vetëm te Zoti i tyre. Dhe, të cilët falin (rregullisht) namazin dhe nga ajo, me çka Ne i furnizuar, ata japin.” (Enfal: 3,4), “Pra ju më kujtoni Mua (me adhurime), Unë ju kujtoj juve (me shpërblim). Më falënderoni e mos Më mohoni.” (Bekare: 152), “Ç’është me ju që All-llahut nuk i shprehni madhërinë që e meritoni? Kur Ai ju krijoi në disa etapa.” (Nuh: 13, 14), “Ti nuk angazhohesh me asnjë çështje, nuk lexon nga ai pjesë nga Kur’ani dhe nuk bëni ndonjë vepër, vetëm se ne jemi prezentuesit tuaj, kur ju ndërmerrni atë. Zotit tënd nuk mund t’i

---

<sup>1</sup> Ahmedi në Musned, 2/381, Alban e vlerëson hadith sahih.

fshihet as në tokë e as në qiell as sa grimca e as më e vogël se ajo e as më e madhe, por vetëm sa është evidentuar në librin e sigurt.” (Junus: 61)

Profeti në lidhje me edukatën me Allahun kishte thënë: “turpërohuni nga Allahu me një turp të vërtetë, ruajeni kokën dhe atë që ajo përmban, stomakun dhe atë përreth dhe përkujtojeni vdekjen dhe shpërbërjen”<sup>1</sup> po ashtu kishte thënë: “turpërimi nga Allahu është më meritore se nga njerëzit.”<sup>2</sup>

Nga edukata e mirë me Allahun është kthyerja tek Ai, kërkimi i faljes dhe ikja për tek Ai, si thotë Allahu i madhëruar: “Pra, ikni e mbështetuni tek All-llahu, unë prej Tij jam një qortues i hapët.” (Dharijat: 50) dhe “Dhe çdo të mirë që e keni, ajo është prej All-llahut, madje edhe kur ju godet e keqja, ju vetëm te Ai e ngreni zërin (me lutje).” (Nahël: 53), “Pra ju më kujtoni Mua (me adhurime), Unë ju kujtoj juve (me shpërblim). Më falënderoni e mos Më mohoni.” (Bekare: 152), “Kush bën vepër të mirë, qoftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne do t’i japim atij një jetë të mirë (në këtë botë), e (në botën tjetër) do t’u japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre.” (Nahël: 97), “Kur lexohet Kur’ani, ju dëgjojeni atë (me vëmendje) dhe heshtni, në mënyrë që të fitoni mëshirë.” (A’raf: 204)

Prej etikës në të cilën u edukua umeti është edukata me Profetin e Allahut derisa ka qenë gjallë si dhe pas vdekjes së tij. Allahu i madhëruar thotë: “O besimtarë, mos bëni asgjë para (se të orientoheni në udhëzimet e) Zotit dhe të dërguarit të Tij, kini kujdes All-llahun, se me të vërtetë All-llahu i dëgjon të gjitha dhe i di të gjitha. O ju që keni besuar, mos ngreni zërin tuaj mbi zërin e Pejgamberit dhe mos iu ngërmoni atij si i ngërmoheni njëri-tjetrit, e të zhduken veprat tuaja duke mos ditur ju. Ata që ulin zërat e tyre pranë të dërguarit të All-llahut, All-llahu zemrat e tyre i ka përshtatur për devotshmëri, ata kanë falje mëkatesh dhe shpërblim të madh. Ata që të thërrasin përtej mureve, shumica e tyre janë që nuk kuptojnë. E sikur ata të bënin durim derisa të kishe dalë ti vetë, do të ishte më edukative për ta, po All-llahu është mëkatfalës, mëshirues.” (Huxhurat: 1-5) Allahu urdhëroi të ndjekim urdhërat e profetit dhe të mos e kundërshtojmë atë: “Thirrjen e të

---

<sup>1</sup> Ahmedi në Musned 1/387

<sup>2</sup> Buhariu 1/73

dërguarit mos e konsideroni si thirrjen tuaj ndaj njëri-tjetrit. All-llahu i di ata që tërhiqen prej jush tinëzisht, prandaj, le të ruhen ata që kundërshtojnë rrugën e tij (të të dërguarit) se ata do t'i zë ndonjë telashe, ose do t'i godasë dënimi i idhët." (Nur: 63), "Për Zotin tënd jo, ata nuk janë besimtarë (të asaj që të zbriti ty as të asaj para teje) derisa të mos zgjedhin ty për të gjykuar në atë konflikt mes tyre, e pastaj (pas gjykimit tënd) të mos ndiejnë pakënaqësi nga gjykimi yt dhe (derisa) të mos binden sinqerisht." (Nisa: 65)

Allahu, krahas eduktës së mirë që duhet të kenë besimtarët me Profetin, i urdhëroi që të mos largoheshin nga tubimet e tij përveç se me lejen e tij: "Besimtarë janë vetëm ata që i besuan All-llahut dhe të dërguarit të Tij, dhe kur janë me të (të dërguarin) për ndonjë çështje të përbashkët (të rëndësishme), nuk largohen pa i kërkuar leje atij. S'ka dyshim se ata që kërkojnë leje prej teje, ata i besojnë All-llahut dhe të dërguarit të Tij. E kur të kërkojnë leje për ndonjë punë të tyre, lejo kë të duash, e kërkoi falje All-llahut për ata, se vërtet, All-llahu falë shumë dhe është mëshirues. Thirrjen e të dërguarit mos e konsideroni si thirrjen tuaj ndaj njëri-tjetrit. All-llahu i di ata që tërhiqen prej jush tinëzisht, prandaj, le të ruhen ata që kundërshtojnë rrugën e tij (të të dërguarit) se ata do t'i zë ndonjë telashe, ose do t'i godasë dënimi i idhët." (Nur: 62,63), "Kur thirren besimtarët për gjykim ndërmjet tyre te All-llahu dhe te i dërguari i Tij, e vetmja fjalë e tyre është të thonë: "Dëgjuam dhe respektoam!" Të tillët janë ata të shpëtuarit. Kush respekton All-llahun dhe të dërguarin e Tij, ia ka frikën All-llahut dhe i përmbahet udhëzimit të Tij, të tillët janë ata që do ta arrijnë atë që dëshirojnë. Ata (hipokritët) betohen me një betim të fortë në All-llahun se sikur t'i urdhëroshe ti, ata gjithsesi do të dilnin (për në luftë). Thuaj: "Mos u betoni!" Bindja është e ditur, (ju vetëm me gojë thoni e jo me zemër). S'ka dyshim, All-llahu hollësisht di çka veproni. Thuaj: "Respektojeni All-llahun dhe respektojeni të dërguarin!" Nëse ata refuzojnë, atëherë atij i takon përgjegjësia me çka është i ngarkuar ndërsa juve përgjegjësia me çka jeni të ngarkuar, nëse i bindeni atij, atëherë keni gjetur të vërtetën. i dërguari ka obligim vetëm komunikimin e qartë." (Nur: 51-54)

Profeti ishte asket dhe porosiste ne asketizëm. Ai cilësohej me cilësitë më të larta që nxisnin në pastërti dhe respekt ndaj të tjerëve, në të ngrënit, në të pirët, në veshje, në flokët dhe pamejn e tij. Urdhërontë në përhapjen e dashurisë dhe



paqes mes njerëzve, thoshte: “dëshironi t’ju tregoj cilin e dua më shumë dhe cili do të jetë më afër meje Ditën e Kiametit? Ata janë më të moralshmit nga ju, të butë me njerëzit që shoqërhen me njerëzit dhe njerëzit shoqërohen me ta”<sup>1</sup>, gjithashtu thoshte: “kush dëshiron të shpëtojë nga zjarri dhe të hyjë në xhenet le ta gjejë vdekja me dëshminë se s’ka zot që meriton të adhurohet pos Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe i dërguar i Tij ndërsa me njerëzit le të sillen ashtu siç dëshiron të sillen ata me të”<sup>2</sup>, siç kishte thënë edhe: “pasha Atë në dorën e të cilit është shpirti im, nuk do të hyni në xhenet derisa besoni dhe nuk keni besuar derisa të duheni mes jush! A dëshironi t’ju tregojë një gjë të cilën nëse e bëni do të duheni? Përhapeni selamin mes jush.”<sup>3</sup> Ai kur kalonte pranë fëmijve ju jepte selam.

Allahu ka urdhëruar të kërkohet leje para se të hyjmë te dikush dhe të përhapim selamin: “O ju që besuat, mos hyni në shtëpi të huaja pa kërkuar leje dhe pa përshëndetur njerëzit e saj. Kjo është më mirë për ju në mënyrë që të merrni mësim.” (Nur: 27), “E robërit e Zotit janë ata që ecin nëpër tokë të qetë, e kur atyre me fjalë u drejtohen injorantët, ata thonë: "Paqe!"” (Furkan: 63), “Dhe mos ec nëpër tokë me mburrje, pse ti as nuk mund ta çashë tokën as nuk mund ta arrishë lartësinë e maleve.” (Isra: 37), “Dhe mos ec nëpër tokë me mburrje, pse ti as nuk mund ta çashë tokën as nuk mund ta arrishë lartësinë e maleve.” (Lukman: 18)

Profeti urdhëronte në sjellje me butësi ngase kjo është shkakton afërsi në familje dhe në shoqëri, ka thënë: “Allahu e do butësinë në çdo çështje”<sup>4</sup>, po ashtu ka thënë: “aty ku gjendet butësia, ajo gjë zbukurohet.”<sup>5</sup> Profeti e zbatoi sjelljen me butësi me shokët e tij: “Ti ishe i butë ndaj atyre, ngase All-llahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do shkapërderdheshin prej teje, andaj ti falju atyre dhe kërko ndjesë për ta, e konsultohu me ta në të gjitha çështjet, e kur të vendosësh, atëherë mbështetu në All-llahun, se All-llahu i do ata që mbështeten.” (Ali Imran: 159)

---

<sup>1</sup> Buhari 4/218

<sup>2</sup> Shiko: Ebu Bekër El-Xhezairij, Minhaxhul muslim, fq: 103

<sup>3</sup> Muslim, 1/53

<sup>4</sup> Buhariu 7/8

<sup>5</sup> Muslimi 8/22

Së bashku me butësinë, profeti ishte i kujdeshsëm për umetin e tij: “Juve ju erdhi i dërguar nga lloji juaj, atij i vie rëndë për vuajtjet tuaja, sepse është lakmues i rrugës së drejtë për ju, është i ndijshëm dhe i mëshirshëm për besimtarët.” (Teube: 128), “Dhe mos ia ngul sytë bukurisë së kësaj jete me të cilën i bëmë të kënaqen disa prej tyre (mosbesimtarë), e për t’i sprovuar me të, sepse shpërbimi i Zotit tënd është më i mirë dhe është i përjetshëm.” (Taha: 131), “E të jeshë i butë ndaj besimtarëve që të pranuan ty.” (Shuara: 215)

Profeti ishte shembull në mëshirë, dhurim dhe moral. Kur i erdhi shpallja për herë të parë u trishtua ndërsa Hadixhja e qëtësoi duke e përkujtuar me moralin e tij: “jo pasha Allahun, Allahu nuk të nënçmon ty asnjëherë, ti respekton farefisën, nihmon nevojtarin, i jep atij që s’ka, mirëpret mysafirin dhe ju ndihmon tw tjerëve në fatkeqësi”<sup>1</sup> dhe kjo ishte vërtetim për tërë umetin se: “virtytet e moralit dhe cilësitë e mira janë shkak për të shpëtuar nga fatkeqësitë”<sup>2</sup>

Kur hyri në Mekë si çlirimtar ishte modest, uli kokën, nuk u mburr dhe nuk hiqej mendjemadh. Ndalej dhe dëgjonte hallet e grave të dobëta dhe fëmijëve, fliste me ta dhe ua kryente nevojat.<sup>3</sup> Transmetimi i Enesit e sqaron këtë: “Profeti vizitonte të sëmurët, prezentonte në xhenaze, hipte mbi gomarë dhe i përgjigjej ftesës së skllavit.”<sup>4</sup> Nuk e kishte problem që së bashku me të të hipte edhe dikush tjetër mbi kafshë, i rritur apo fëmijë. Shpeshherë me të hipte Usame b. Zejd, radijallahu anhumu, dhe herë ndonjë nga gratë e tij.<sup>5</sup> Ai thoshte: “Allahu më ka shapllur: bëhuni modest dhe askush të mos i mburret tjetrit”<sup>6</sup>

Ai punonte së bashku me shokët e tij në udhëtim, mblidhte drunj dhe bëntë një pjesë të punës sikur çdonjëri nga njerëzit. Mori pjesë në ndërtimin e xhamisë së tij ashtu siç ndihmonte familjen në punët e shtëpisë. Ishte i turpshëm dhe kështu e cilësoi Allahu në Kuran: “O ju që besuat, mos hyni në shtëpitë e Pejgamberit ndryshe vetëm nëse u lejohet për ndonjë ngrënie e duke mos pritur përgatitjen e saj, por kur të thirreni, atëherë hyni, e kur të jeni ushqyer, atëherë shpërndahuni,

---

<sup>1</sup> Buhariu: 1/3

<sup>2</sup> Ahmed b. Abdulaziz El-Haddad, Ahlakunnebij fil Kur’ani ues-Sune, 1/77

<sup>3</sup> Sahih Muslim, tema: afërsia e profetit me njerëzit.

<sup>4</sup> Tirmidhij, hadithi nr: 1017

<sup>5</sup> Buhariu 7/116

<sup>6</sup> Ibn Maxheh, hadithi nr: 4179

duke mos hyrë në bisedë me njëri-tjetrin, vërtet këto (pritja, qëndrimi, biseda) e mundojnë Pejgamberin, por ai turpërohet prej jush; All-llahu nuk i turpërohet realitetit. E kur kërkoni prej tyre (grave të Pejgamberit) ndonjë send, atë kërkoheni pas perdes, kjo është më pastër për zemrat tuaja dhe të tyre. Juve nuk u takon ta mundoni të dërguarin e All-llahut, e as të martoheni kurrë me gratë e tij, pas (vdekjes së) tij. Këto janë tek All-llahu mëkat i madh.” (Ahzab: 53). Ai thërristë në mesatari për sa i përket kësaj dhe botës tjetër: “Dhe me atë që të ka dhënë All-llahu, kërko (ta fitosh) botën tjetër, e mos lë mangu atë që të takon nga kjo botë, dhe bën mirë ashtu siç të ka bërë All-llahu ty, e mos bën të këqija në tokë, se All-llahu nuk i do çrregulluesit.” (Kasas: 77)

Ai ua shprehte dashurinë shokvë të tij. Një ditë Muadh i tha: “o Muadh, unë të dua për hir të Allahut, të porosis të mos e lësh pas çdo namazi të thuash: o Allah! Më ndihmo të të përmed, të të falendëroj dhe të të adhuroj mirë!”<sup>1</sup>

Gjithashtu ka thënë: “kur ndonjëri e don vëllain e tij, le ta informoj për këtë”<sup>2</sup> Ai nxiste në çdo që gjë që përhapte dashurinë mes njerëzve sikur: vizita, dhurata<sup>3</sup>, buzëqeshja për të cilën tha: “buzëqeshja në fytyrën e vëllait tënd është lëmoshë.”<sup>4</sup> I mësonte shokët e tij të përshëndesin njëri tjetrin “Ju do të hasni në hasni në të tjerë, që duan të sigurohen te ju (duke u paraqitur si besimtarë) dhe të sigurohen te populli i vet (si jobesimtarë). E, saherë që thirren, (kundër jush) i përgjigjen thirrëjes. Në qoftë se nuk largohen prej jush, nuk ju ofrojnë paqe dhe nuk heqin dorë nga lufta kundër jush, atëherë kapeni dhe mbytni kudo që t’i takoni. Kundër tyre u kemi dhënë fakte të qarta.” (Nisa: 91)

Buhariu në Sahihun e tij shkroi një temë me titullin: “Përhapja e selamit është prej Islamit”<sup>5</sup> ndërsa në kapitullin e imanit, shkroi: “Selami është prej Islamit” ndërsa Tirmidhiu në sunenein e tij shkroi: “Vlera e selamit”

Kurani ndaloi diskriminimin njerëzor, mwsoi njerëzit për zanafillën e përbashkët dhe ndaloi fyerjet ndaj njëri tjetrit: “O ju që besuat, nuk bën të tallet një popull

---

<sup>1</sup> Ahmedi në Musned, 4/30

<sup>2</sup> Ahmedi në Musned 4/30

<sup>3</sup> Tirmidhij, hadithi nr: 1953

<sup>4</sup> Tirmidhij, hadithi nr: 1956

<sup>5</sup> Buhari, 7/128

me një popull tjetër, meqë të përqeshurit mund të jenë më të mirë nga ata të cilët përqeshin dikë tjetër, e as gratë me gratë e tjera, sepse mund të ndodhë që gratë e tjera të jenë më të mira se ato që përqeshin (duke e nënçmuar njëri-tjetrin) dhe mos etiketoni njëri-tjetrin me llagape. Pas besimit është keq të përhapet llagapi i keq. E ata që nuk pendohen, janë mizorë. O ju që keni besuar, largohuni prej dyshimeve të shumta, meqë disa dyshime janë mëkat dhe mos hulumtoni për zbulimin e të metave të njëri-tjetrit, dhe mos përgjoni njëri-tjetrin; a mos ndonjëri prej jush dëshiron të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur? Atë pra e urreni! Kini frikë nga ndëshkimi i All-llahut, e All-llahu është mëshirues, Ai pranon shumë pendimin. O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se te All-llahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (këqijat), e All-llahu është shumë i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë.” (Huxhurat: 11-13) Pohoi se besimtarët janë vëllezër: “S'ka dyshim se besimtarët janë vëllezër, pra bëni pajtim ndërmjet vëllezërve tuaj dhe kini frikë All-llahun, që të jeni të mëshiruar (nga Zoti).” (Huxhurat: 10). E bëri detyrim pajtimin mes tyre në rast të zënkave dhe të merret qëndrim kundër të padrejtit duke punuar në pajtimin mes tyre: “Nëse dy grupe besimtarësh tentojnë të luftojnë ndërmjet vete, ju pajtoni ata, e në qoftë se ndonjëri prej tyre e sulmon tjetrin, atëherë luftojeni atë grup që vërsulet me pa të drejtë, derisa t'i bindet udhëzimit të All-llahut, e nëse kthehet, atëherë me drejtësi bëni pajtimin ndërmjet tyre, mbani drejtësinë, se vërtet All-llahu i do të drejtë.” (Huxhurat: 9)

Profeti ndali përgojimin<sup>1</sup> dhe nënçmimin e njëri tjetrit: “njeriut i mjafton e keqja të nënçmojë vëllain e tij mysliman.”<sup>2</sup> Allahu i madhëruar thotë: “O ju që besuat, u është bërë obligim gjurmimi për dënim për mbytje: i liri për të lirin, rob për robin, femra për femrën. Kurse atij që i falet diçka nga vëllai i vet, atëherë ajo le të përcillët (e atij që fal) kuptueshëm dhe shpagimi (nga dorasi) atij le t'i bëhet me të mirë. Kjo është një lehtësim dhe mëshirë prej Zotit tuaj. E kush tejkalon pas këtij (pajtimi), ai ka një dënim të idhët.” (Bekare: 178), “Të ndershmit dhe të pasurit nga ju, të mos betohen se nuk do t'u japin të afërmve, të varfërve dhe atyre që

---

<sup>1</sup> Tirmidhiu, 4/329

<sup>2</sup> Tirmidhiu, hadithi nr: 1927

për hir të All-llahut lanë vendlindjet e tyre, po le t'ua falin (gabimin) dhe mos t'ua zënë për të madhe. A nuk dëshironi që All-llahu t'u falë ju? All-llahu falë dhe mëshiron shumë.” (Nur: 22), “Ndëshkimi i të keqes bëhet me një të keqe në të njëjtën masë, e kush fal e bën pajtim, shpërblimi i tij është tek All-llahu. Vërtet, Ai nuk i do zullumqarët.” (Shura: 40), “41:34. Nuk është e barabartë e mira dhe e keqja. Andaj, (të keqen) ktheje në mënyrën më të mirë, se atëherë ai, me të cilin kishit njëfarë armiqësie, do të bëhet mik i afërt.” (Fusilet: 34), “Të cilët japin kur janë shilirë edhe kur janë në vështirësi dhe që e frenojnë mllefin, që ua falin (të keqen) njerëzve, e All-llahu i do bamirësit.” (Ali Imran: 174)

Tërë kjo barazi mes njerëzve, vlerësim mes njëri tjetrit dhe pajtim mes të hasmuarve ishte për të ngritur një shoqëri islame, morale, të bashkuar dhe të lidhur mes vete: “Në shumë biseda të tyre të fshehta nuk ka kurrfarë dobie, përveç (bisedës) kush këshillon për lëmoshë, për ndonjë të mirë ose pajtim mes njerëzve. E kush i bën këto duke pasur për qëllim vetëm kënaqësinë e All-llahut, Ne do ti japim më vonë (në botën tjetër) shpërblim të madh.” (Nisa: 114)

Allahu dhe Profeti urdhëruan që të jemi të mëshirshëm dhe që të këshillojmë njëri tjetrin për mëshirë: “E pastaj të bëhej prej atyre që besuan, që këshilluan njëri-tjetrin për durim dhe që këshilluan për mëshirë (për ndihmë).” (Beled: 17) Ndërsa Profeti ka thënë: “Allahu nga robërit e Tij i mëshiron ata që janë të mëshirshëm”<sup>1</sup>, po ashtu ka thënë: “mëshironi atë që është në tokë ju mëshiron Ai që është në qiell”<sup>2</sup> Ai vuri theksin mbi mëshirën e ndërsjellë mes muslimanëve që do udhëhiqte me shoqëinë: “shembulli i besimtarëve në dashurinë dhe mëshirën e ndërsjellë është sikur shembulli i një trupi, nëse një organ ankohet i tërë trupi ndien dhimbjen me pagjumsi dhe ethe”<sup>3</sup>

Namazi ishte ndër adhurimet më të rëndësishme të Profeti, megjithkëtë ai e falte shpejtë si mëshirë për fëmijët. Buhariu ka shënuar se Ebu Katade kishtë dëgjuar Profetin dukë thënë: “ndodh që hyj në namaz dhe dëshiroj ta zgjas atë. Dëgjoj

---

<sup>1</sup> Buhari 2/81

<sup>2</sup> Tirmidhij, 4/324

<sup>3</sup> Muslimi, 8/20

ndonjë fëmijë duke qarë dhe e përshpejtoj namazin ngase e di vështirësinë që ndjen nëna nga të qarët e fëmijës së saj”<sup>1</sup>

Ai ishte i mëshirshëm me skllëvërit dhe shërbëtorët. Lirimin e tyre e llogariste nga adhurimet më të mëdha dhe shlyerje të shumë mëkateve. Islami e ngushtoi derën e skllavërisë pasi që ishte e hapur në të gjitha ligjet dhe sistemet në periudhën profetike. Ai porositi që me ta të sillen mirë: “vëllezërit tuaj janë shërbëtorët tuaj. Allahu i lë në pushtetin tuaj. Kush e ka vëllanë nën pushtetin e tij le ta ushqejë nga ajo që ushqehet vetë dhe le ta veshë nga ajo që veshë vetë. Mos i ngarkoni me punë që s’mund t’i bëjnë, e nëse i ngarkoni ndihmojuni. Asnjëri të mos thotë: ky është robi im ose robëresha ime por le të thotë: djali im ose vajza ime.”<sup>2</sup>

Kjo mëshirë dhe etikë humane nuk përfundon tek muslimani dhe njeriu por ligjet islame e përcjellin edhe te kafshët, duke i mëshiruar, ushqyer, duke mos i dënuar apo vvarë. Profeti tha: “në bamirësinë ndaj çdo gjallese ka shpërblim”<sup>3</sup> po ashtu ka thënë: “një grua do të hyjë në zjarr për shkak një maceje të cilën e mbylli derisa ngordhi, as nuk e ushqeui as nuk e la të hante nga bimët e tokës”<sup>4</sup>

“Allahu e mallkoi atë që merr për shënjestër diçka që ka shpirt”<sup>5</sup>

Të gjitha këto udhëzime flasin për të drejtat e kafshëve. Islami ia kaloi me shekuj botës moderne në aspekt. Këto mësimë janë prej mëshirës së Zotit që ua ligjësoi besimtarëve në mënyrë që të bëhen mëshirë për çdo krijesë e mos të flasim për njeriun.

Islami i ka dhënë rëndësi ndihmës së njerëzve, mbështetjes së nevojtarëve prej tyre, mos dëmtimi i të tjerëve qofshin burra ose gra. Allahu i madhëruar thotë: “Të ndershmit dhe të pasurit nga ju, të mos betohen se nuk do t’u japin të afërme, të varfërve dhe atyre që për hir të All-llahut kanë vendlindjet e tyre, po le t’ua falin (gabimin) dhe mos t’ua zënë për të madhe. A nuk dëshironi që All-llahu

---

<sup>1</sup> Buhariu

<sup>2</sup> Ahmedi në Musned 2/247

<sup>3</sup> Buhari, 3/77

<sup>4</sup> Buhari, 3/77

<sup>5</sup> Ahmedi në Musned 1/216, Muslimi 6/73

t'u falë ju? All-llahu falë dhe mëshiron shumë. Vërtet, ata që akuzojnë gratë e ndershme, besimtare të pafajshme, janë të mallkuar në këtë botë dhe në botën tjetër dhe ata i pret një dënim shumë i madh. Në atë ditë kur dëshmojnë kundër tyre gjuhët e tyre, duart dhe këmbët e tyre për atë që ata kanë punuar. Atë ditë All-llahu ua plotëson shpërblimin e merituar, e ata e dinë se All-llahu është Ai i vërteti, i qarti në drejtësi.” (Nur: 22-25)

Kurani i dha rëndësi edhe raporteve të mira me fqinjët: “Adhurojeni All-llahun e mos i shoqëroni Atij asnjë send, silluni mirë ndaj prindërve, ndaj të afërmve, ndaj jetimëve, ndaj të varfërve, ndaj fqiu të afërt, ndaj fqiu të largët, ndaj shokut pranë vetes, ndaj udhëtarit të largët dhe ndaj robërve. All-llahu nuk e do atë që është kryelartë dhe atë që lavdërohet.” (Nisa: 36) Ndërsa Profeti ka thënë: “kush beson Allahun dhe botën tjetër le të mos e dëmtojë fqinjin”<sup>1</sup>, “Pasha Allahun nuk ka besuar, pasha Allahun nuk ka besuar! Thanë: kush o i Dërguar i Allahut? Ai fqinji i të cilit nuk është rehat prej tij – u përgjigj.”<sup>2</sup> Kjo nuk është e veçantë vetëm për muslimanët por për të gjithë ata që janë paqësorë, me një urdhër të prerë dhe të qartë: “All-llahu nuk ju ndalon të bëni mirë dhe të mbani drejtësi me ata që nuk ju luftuan për shkak të fesë, e as nuk ju dëbuan prej shtëpive tuaja; All-llahu i do ata që mbajnë drejtësinë.” (Mumtehine: 8) Gjithashtu urdhëroi mirësjelljen ndaj robërve të luftës, nga armiqtë: “Ata janë që për hir të Tij u japin ushqim të varfërve, jetimëve dhe të zënëve robër.” (Insan: 8)

Profeti urdhëroi besimtarët që të silleshin mirë me robërit e Bedrit dhe politeistët tjerë dhe si pasojë ata i ushqenin robërit nga ajo që hanin vetë, silleshin mirë me ata gjë që ndikoi tek ata që të pranojnë Islamin më vonë.

Nga virtytet më të shkëlqyera mbi të cilat u ngrit umeti është bujaria dhe dhurimi. Dhurimi është i njohur për umetin në shumë sfera, prej kësaj është edhe dhurimi i pasurisë qoftë nëpërmjet zekatit apo lëmoshave tjera të cilat janë përmendur në më shumë se një vend së bashku me namazin: “Është e vërtetë se njeriu është i prirur të jetë i padurueshëm. Pse kur e godet ndonjë e keqe, ai ankohet së tepërmi. Ndërkaq, kur e gjen e mira, ai bëhet tepër koprrac. Përveç atyre që falen,

---

<sup>1</sup> Buhariu, 7/78

<sup>2</sup> Buhariu 7/78

të cilët janë të rregullt në faljen e namazit të tyre. Dhe ata që në pasurinë e vet kanë ndarë një pjesë të caktuar. Për lypësin dhe për nevojtarin që nuk lyp. Edhe ata që e besojnë bindshëm ditën e gjykimit.” (Mearixh: 19-26), “E, sa i përket atij që jep dhe ruhet, Dhe vërteton bindshëm për më të mirën, Ne do ta përgatitim atë për më të lehtë. E sa i përket atij që bën koprraci dhe ndien veten të pavarur (nga Zoti), Dhe që përgënjeshton atë më të mirën, Ne do ta përgatisim për më të vështirën. E pasuria e tij nuk do t’i bëjë dobi, kur ai të zhduket. Detyrë e jona është vetëm të udhëzojmë.” (Lejl: 5-12), “Nuk është obligim yti (Muhammed) udhëzimi i tyre (në rrugë të drejtë), All-llahu e shpie në rrugë të drejtë atë që do. Çkado që të jepni nga pasuria, e keni për veten tuaj, po mos jepni për tjetërkë, por vetëm për hir të All-llahut, e çkado që t’u jepni të tjerëve nga pasuria, ajo do t’u kompensohet në mënyrë të plotë duke mos u dëmtuar ju.” (Bekare: 272), “O ju që keni besuar, para se të vijë një ditë kur nuk do të ketë as shitblerje, as miqësi, e as ndërmjetësim, jepni nga ajo me çka Ne u furnizuar juve. Pabesimtarët janë mizorë.” (Bekare: 254)

Në një hadith profetik thuhet: “Allahu është bujar dhe e do bujarinë”<sup>1</sup>

Për të menjanuar zilinë, mllëfin dhe për të qëndruar larg luftës për pasuri, Profeti kishte thënë: “ruhuni nga lakmia e tërbuar, ngase ajo i shkatërroi ata para jush, i çoi të derdhnin gjaqet dhe të ljenonin ndalesat”<sup>2</sup>

Ky udhëzim fisnik për të ndërtuar umetin dhe shoqërinë e tij mbi virtytin e bujarisë dhe dhurimit ishte praktikë e Profetit në jetën e tij të përditshme, aq sa u njoh si njëri më bujar në botë. Ai nxishte në dhënien e lëmoshës qoftë edhe pak, ai thoshte: “ruhuni nga zjarri qoftë edhe me një gjysëm hurme.”<sup>3</sup> Musliamnët në kohën e tij bënë garra në dhënien e lëmoshës dhe shpenzimin për nevojtarët, përgatitjen e ushtrisë dhe nderimin e mysafirëve. Në krye të tyre ishte Othman b. Affani, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, i cili përgatiti xhejshel usreti (ushtrinë e vështirësive).

---

<sup>1</sup> Tirmidhiu, hadithi nr: 2799

<sup>2</sup> Muslimi 8/18

<sup>3</sup> Buhariu, 2/114



Përmbushja e premtimit ishte një nga virtytet më të rëndësishme të Profetit dhe muslimanëve në përgjithësi. Profeti e zbatoi në jetën e tij më dashmirët dhe me armiqtë e tij dhe shoqërinë e ngriti mbi të, “Nuk është tërë e mira (e kufizuar) t’i ktheni fytyrat tuaja kah lindja ose perëndimi, por mirësi e vërtetë është ajo e atij që i beson All-llahut, ditës së gjykimit, engjëjve, librit, peygamberëve dhe pasurinë që e do ua jep të afërmve, bonjakëve, të varfërve, udhëtarëve, lypësve dhe për lirim e robërve, dhe ai që e fal namazin, e jep zeqatin, dhe ata që kur premtojnë e zbatojnë, dhe të durueshmit në skamje, në sëmundje dhe në flakën e luftës. Të tillët janë ata të sinqertit dhe të tillët janë ata të devotshmit.” (Bekare: 177), “O ju që besuat! Zbatoni premtimet (obligimet). U janë (lejuar t’i hani) kafshët shtëpiake, me përjashtim të atyre që po ju lexohen (në këtë kaptinë si të ndaluara) dhe përveç gjuetisë, që nuk është e lejuar derisa jeni në ihram. Vërtet, All-llahu vendos atë që dëshiron.” (Maide: 1)

Profeti ju premtonte dhe bënte marrëveshje me shumë fise përreth Medines dhe mbante premtimet. Ai bëri marrëveshje edhe me disa hebrenjë me të arritur në Medine dhe e mbajti premtimin derisa ata nuk tradhtuan. Ai bëri marrëveshje me kurejshët në Hudejbije dhe nuk e theu marrëveshjen edhe pse në pamje të jashtme dukej si padrejtësi ndaj disa muslimanëve të shtypur.<sup>1</sup> Kur pala tjetër thyen marrëveshjen atëherë pala muslimane publikisht zhvleftësoi marrëveshjen, jo në mënyrë tradhëtare: “Nëse ti e heton tradhtinë e një populli (ndaj marrëveshjes), atëherë edhe ti ua hidh atyre (marrëveshjen) në mënyrë të njëjtë, sepse All-llahu nuk i do ata që tradhtojnë (fshehurazi).” (Enfal: 58)

Allahu e urdhëroi të respektojë marrëveshjet dhe ai nuk i theu asnjëherë: “Denoncim nga All-llahu dhe i dërguari i Tij ndaj idhujtarëve me të cilët ju patët lidhur kontratë (kumtesë për shkëputjen e marrëveshjes). Pra, ju (idhujtarë) qarkulloni nëpër tokë (lirisht) katër muaj, e dijeni se fuqinë e All-llahut nuk mund ta bëni të paaftë dhe se All-llahu i mposhtë mohuesit. Dhe (ky është) një kumtim nga All-llahu dhe i dërguari i Tij drejtuar të gjithë njerëzve në ditën e haxhit të madh, se All-llahu është tërhequr prej (marrëveshjes së) idhujtarëve, e njëkohësisht edhe i dërguari i Tij. Po nëse pendoheni, do të jetë më mirë për ju, e

---

<sup>1</sup> Ebu Davud, hadithi nr: 2758

nëse ia ktheni shpinën (rrugës së drejtë), ta dini se nuk mund t'i shpëtoni (ndjekjes së) All-llahut. E, ti përgëzoi ata që mohuan me një dënim të padurueshëm. Pos atyre idhujtarëve me të cilët keni lidhur marrëveshje, e të cilët nuk ju kanë shmangur asgjë dhe nuk e kanë ndihmuar askënd kundër jush, pra, edhe ju përmbushni marrëveshjen e tyre deri në afatin e caktuar. S'ka dyshim se All-llahu i do të devotshmit.” (Teube: 1-4)

Zbatimi i amanetit ishte nga virtytet themelore të Profetit: “Ne ua ofruam amanetin (obligimet) qiejve, tokës dhe maleve, e ato nuk deshën ta marrin përsipër atë dhe u frikësuan prej tij, ndërsa njeriu atë e mori mbi vete; dhe ai i bëri padrejt vetes, dhe ishte i padijshëm.” (Ahzab: 72)

Profeti ishte shëmbulltyrë para se t'i vijë shpallja hyjnore dhe pas në zbatimin e amanetit. Atë e quajtën Sadikul-Emin që d.m.th. i sinqerti- besniku. Sinqeriteti ishte karakteri i tij, Allahu e lavdëroi me të: “E ai që e solli të vërtetën dhe ai që e vërtetoi atë, të tillët janë ata të ruajturit.” (Zumer: 33). Profeti nxiste në sinqeritet dhe i edukonte njerëzit në këtë virtyt: “ju porosis në sinqeritet ngase sinqeriteti të çon në punë të mira ndërsa punët e mira të çojnë në xhenet. Njeriu vazhdon të jetë i sinqertë dhe të zgjedh sinqeritetin derisa të rregjistrohet tek Allahu i sinqerti. Ruhuni nga gënjeshtria ngase gënjeshtria të çon në punë të këqija e punët e këqija të çojnë në zjarr, njeriu vazhdon të gënjejë dhe të zgjedh gënjeshtren derisa të rregjistrohet tek Allahu gënjeshtari.”<sup>1</sup> Ai tërhoqi vërejtjen nga këto cilësi: “shenjat e hipokritit janë tre: kur felt gënjen, kur premtion e then premtimin dhe kur i lihet diçka në besim tradhton”<sup>2</sup>

Sa i takon aspektit të moralit shoqëror familjar, Islami i ka dhënë rëndësi përvetësimit të tij duke pasur parasysh mundësinë e mospajtimeve, gërshetimin e lidhjeve, për këtë arsye legjislacioni islam hodhi themelet e tij edhe në gjendjet civile, kodin familjar duke përfshirë këtu lidhjet martesore, shkurorëzimin dhe zënkat që shoqërohen me të, shpenzimet, kujdesjen ndaj fëmijëve, edukimin, mbikqyrjen dhe përgjegjësitë. Caktoi të drejta të qarta dhe kufij në çdo aspekt, askush askujt nuk i bën padrejtësi dhe askush nuk shkel të drejtën e askujt.

---

<sup>1</sup> Muslimi, 8/29

<sup>2</sup> Buhariu, 1/14

Muslimanëve ua tërhoqi vërejtjen nga shkelja e këtyre rregullave dhe ligjeve hyjnore. Ajo që është përmendur në suren Bekare nga dispozitat dhe rregullat e kësaj lëmie, sqaron më mirë precizitetin e këtij organizimi: “Ata që betohen se do të largohen prej grave të tyre (të mos bëjnë kontakt me to), afati i pritjes është katër muaj. Në qoftë se kthehen ata (heqin dorë nga betimi), s'ka dyshim, All-llahu bën falje dhe mëshiron. E në qoftë se ata kanë vendosur për shkurorëzim, All-llahu dëgjon (fjalët e tyre) i di (qëllimet e tyre).bE ato gra që janë shkurorëzuar janë të obliguara të presin tre menstruacione. Nëse ato i besojnë All-llahut dhe ditës së fundit, atyre nuk u lejohet ta fshehin atë që All-llahu e krijoi në mitrat e tyre. E burrat e tyre kanë më shumë të drejta që gjatë asaj kohe, nëse duan pajtim, t'i rikthejnë ato. Edhe atyre (grave) u takon e drejta sikurse edhe përgjegjësia në bashkëshortësi, e burrave u takon një përparësi ndaj tyre. All-llahu është i gjithëfuqishëm, i urtë. Lëshimi (pas të cilit mund të bëhet rikthimi) është dy herë, e (pastaj) ose jetë e njerëzishme (bashkëshortore) ose shkurorëzim me mirëkuptim. E juve (burrave) nuk u lejohet t'u merrni asnjë send nga ajo që u keni dhuruar (si niqah), vetëm nëse që të dy frikësoheni se nuk do të mund t'i ruani dispozitat e All-llahut (në bashkëshortësi). E nëse keni frikë se ata të dy nuk do të mund t'i ruajnë dispozitat e All-llahut, atëherë për atë, me çka ajo bën kompensim, për ata të dy nuk ka mëkate. Këto janë dispozita të All-llahut, pra mos i kundërshtoni, sepse kush i tejkalon dispozitat e All-llahut, pikërisht të tillët janë zullumqarët. E në qoftë se ai (burri) e lëshon atë (për herë të tretë), pas atij (lëshimi) nuk lejohet më derisa të martohet ajo për një burrë tjetër. E nëse ai (burri i dytë) e lëshon atë, atëherë për ata dy, po qe se mendojnë se do t'i zbatojnë dispozitat e All-llahut, nuk ka pengesë të rikthehen (në bashkëshortësi). Këto janë dispozita të All-llahut që ia sqaron një populli që kupton. E kur t'i keni lëshuar gratë dhe ato i afrohen afatit të tyre, atëherë ose mbani si duhet ose i lëni si duhet (të kryejnë afatin), e mos i mbani sa për t'i dëmtuar, e të bëheni të padrejtë. E kush bën atë, ai e ka dëmtuar vetveten. Dispozitat e All-llahut mos i merrni për shaka. Përkujtoni të mirat e All-llahut ndaj jush edhe atë që ua shpalli Kur'anin dhe dispozitat e sheriatit me të cilat ju udhëzon, dhe keni frikë All-llahun e dijeni se All-llahu është i gjithëdijshtë për çdo send. Dhe kur i lëshoni gratë, e ato e përmbushin afatin e tyre (të pritjes), nëse pëlqejnë mes vete ashtu si kërkojnë rregullat, mos i pengoni që të martohen për burrat e tyre. Me këtë

këshillohet ai që prej jush e beson All-llahun dhe botën tjetër, kjo është më e dobishme për ju, më e pastër, se All-llahu e di, e ju nuk e dini. Nënata, ato që duan ta plotësojnë gjidhënien, janë të obliguara t'u japin gji fëmijëve të vet dy vjet të plota. i ati i fëmijës është i obliguar për furnizimin dhe veshmbathjen e tyre (gruas) ashtu si është rregull. Askush nuk ngarkohet më tepër, vetëm aq sa ka mundësi. Asnjë nënë nuk bën të dëmtohet me fëmijën e saj, e as babai me fëmijën e tij. Po ashtu është i obliguar edhe trashëgimtari (i fëmijës). E nëse pas një konsultimi dhe pëlqimi (prindërit) shfaqin dëshirën për ndërprerjen (më herët) e gjinit, nuk është ndonjë mëkat për ta. Nëse ju (baballarët) për fëmijën tuaj dëshironi gjidhënese tjetër me kusht që pagesën t'ia bëni në mënyrë të duhur, nuk është ndonjë mëkat. Kini frikë nga All-llahu dhe dini se All-llahu sheh çka punoni. E ata që vdesin dhe lënë gra pas vete, ato (gratë) presin katër muaj e dhjetë ditë. E kur ta kryejnë ato afatin e tyre, nuk është mëkat për ju (familja kujdestare) për atë që bëjnë ato në mënyrë të njerëzishme me veten e tyre. All-llahu hollësisht e di çka veproni. Paraqitja juaj për martesë ndaj grave (që kanë kryer afatin e tyre), në mënyrë të tërthortë, ose mbajtja fshehtë në veten tuaj, nuk është mëkat për ju. All-llahu e di se ju do t'ua përmendni atyre (dëshirën për martesë), por kurrësi mos u premtoni atyre fshehtëzi (diç tjetër), përpos t'u thoni fjalë të lejuara. Dhe mos vendosni lidhjen e kurorës derisa të përfundojë afati i caktuar. Ta dini se All-llahu e di çka fshehni në vete, pra kini frikë prej Atij, dhe dini se All-llahu falë shumë, është i butë. Nuk është mëkat për ju nëse i lëshoni gratë pa pasur kontakt (martesë) me to dhe para se t'u caktoni atyre ndonjë caktim (kurorë-nikah), po pajisni ato (me ndonjë pajisje), pasaniku sipas mundësisë së tij dhe i varfëri sipas mundësisë së tij. Një pajisje e zakonshme është obligim për bëmirisit. E nëse i lëshoni ato para se të kontaktoni, por u keni pas caktuar atyre një caktim (kurorë), atëherë duhet t'u jepni gjysmën e asaj që e keni caktuar, përveç nëse ato ju falin ose ju falë ai në duart e të cilit është lidhja e kurorës. E të falni (burra ose gra) është më afër devotshmërisë, e mos e harroni bamirësinë ndërmjet jush. Vërtet, All-llahu sheh atë që veproni.” (Bekare: 226-237)

Ka edhe rregulla të tjera që kanë të bëjnë me martesën duke filluar prej fejesës deri tek ndarja. Bashkëshortët i urdhëroi të kenë bashkëjetesë të mirë: “O ju që

besuat, nuk është lejuar për ju të trashëgoni gratë (e të vdekurve) në mënyrë të dhunshme, e as t'i shtrëngoni për t'u marrë diçka nga ajo që ju keni dhënë atyre, përveç nëse ato bëjnë ndonjë imoralitet të hapur. Çoni jetë të mirë me to. Nëse i urreni ato, bëni durim pse ndodh që All-llahu të japë shumë të mira në një send që ju e urreni.” (Nisa: 19). Kjo sure në Kuran u quajt Nisa (gratë) për të ngritur pozitën e tyre në sytë e shoqërisë. Legjislacioni islam gruan e bëri të përfaqësuar nga nëna – njeriu më i shtrenjtë dhe më meritoi për bamirësi. Jetën bashkëshortore e ngriti mbi dashuri, mëshirë dhe qetësi që janë më madhështore se dashuria: “ Shiko se si Ne i kemi dalluar disa prej të tjerëve, po dallimi në botën tjetër është më i madh dhe është përparësi më e madhe.” (Isra: 21)

Bashkëshortin e urdhëroi të bëjë atmosferë të këndshme me familjen dhe bashkëshorten e tij, të bëhet i dashur ndersa bashkëshorten e urdhëroi t'i bindet burrit të saj.<sup>1</sup>

Dispozitat fetare ndalojnë lidhjet seksuale jashtë suazave martesore për shkak se dëmtojnë të lindurit pa baballarë, dobësojnë lidhjet bashkëshortore dhe prishin gratw dhe burrat për njëri tjetrin, duke ia shtuar kwsaj edhe sëmundjet trupore. Marrëdhëniet intime jashtëmartesore (zinaja) konsiderohen nga mëkatet e mëdha, madje urdhëroi njeriun, mashkull qoftë apo femër të ulë shikimin e tij dhe të mos shikojë përpos aty ku e ka të lejuar prej bashkëshorteve dhe grave me të cilat nuk ka të drejtë të martohet (meharim): “Thuaju besimtarëve të ndalin shikimet (prej haramit), t'i ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre se kjo është më e pastër për ta. All-llahu është i njohur hollësisht për atë që bëjnë ata. Thuaju edhe besimtareve të ndalin shikimet e tyre, t'i ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, të mos zbulojnë stolitë e tyre përveç atyre që janë të dukshme” (Nur: 30, 31)

Këto ajete përmbledhin sjelljen dhe moralin që e bëjnë njeriun të mos shikojë përpos në familjen e tij, njëashtu edhe gruan. Shikimi nuk lejohet në mënyrë që ta largojë njeriun nga çdo shkak që e çon në lidhje të ndaluar, pra është preventivë dhe mjekim paraprak për të ngritur besimin mes bashkëshortëve. Në të njejtën

---

<sup>1</sup> El-Kemedanij, Fen teamulin-nebij fil hajat zeuxhije, fq: 60

kohë kur Profeti ngrii shoqërinë islame mbi vlerat më të larta morale ai tërhoqi vërejtjen nga cilesitë amorale, prej tyre: padrejtësinë ndaj njerëzve: “Ja (All-llahu u thotë idhujtarëve), këta ju përgënjeshtroan për atë që thoni (se ishin zota), pra ju as nuk keni mundësi të shpëtoni as t’i ndihmoni (vetes). E cilido që bën padrejtësi prej jush, Ne i japim atij të përjetojë një dënim të madh.” (Furkan: 19), ndërsa Profeti ka thënë: “ruhu nga lutja e atij që i është bërë padrejtësi sepse mes saj dhe Allahut nuk ka perde”<sup>1</sup>. Tërhoqi vërejtjen nga zilia: “A u kanë zili atyre njerëzve për atë që All-llahu u dha nga mirësitë e Tij? Ne u patëm dhënë pasardhësve të Ibrahimit librin e shariatit dhe u patëm dhënë atyre pushtet të madh.” (Nisa: 54)

Profeti tërhoqi vërejtjen nga mashtrimi, ai tha: “kush mashtron nuk është prej nesh.”<sup>2</sup> Tërhoqi vërejtjen nga veprat për sy e faqe: “Pra shkatërrim është për ata që falen, Të cilët ndaj namazit të tyre janë të pakujdesshëm. Ata që vetëm shtiren (sa për sy e faqe). Dhe nuk japin as sendin më të vogël (as hua).” (Maun: 4-7) profeti për veprat për sy e faqe tha: “ajo që më shumti ua kam frikën është shirku i vogël. E pyetën: ç’është shirku i vogël? Veprat për sy e faqe – tha ai.”<sup>3</sup>

Ai ndaloi edhe nga vetëmashtrimi, vetëpëlqimi dhe e llogariti nga veprat më shkatërruese siç tha: “tre vepra janë shkatërruese: lakmia e tërbuar, pasimi i epshit dhe vetëpëlqimi.”

Ai urdhëroi që njeriu të mos mashtrohet me pasurinë, adhurimin, fuqinë, autoritetin apo punën e tij, ai tha: “asnjërin nuk do ta shpëtojë vepra e tij. Thanë: as ty o i Dërguar i Allahut? Tha: as mua nëse nuk më përfshinë Allahu me mëshirën e tij”<sup>4</sup>

Profeti urrente përtacinë dhe kërkonte mbrojtjen nga ai ves: “o Allah kërkoi mbrojtjen tënde nga paaftësia, përtacia, frika, pleqëria e thellë dhe kopracia!”<sup>5</sup>

---

<sup>1</sup> Buhariu, 3/99

<sup>2</sup> Muslimi, 1/69

<sup>3</sup> Ahmedi në Musned, 5/428

<sup>4</sup> Muslimi, 8/139

<sup>5</sup> Muslimi, 8/139

Nga gjërat më të rëndësishme që Islami ia ofroi shoqërive njerëzore është vëmendja ndaj kohës dhe organizimi i saj. Bëri dallimin mes punës gjatë ditës dhe pushimit gjatë natës, shfrytëzimi i kohës në gjëra që të sjellin dobi, moshumbja e kohës në gjëra që nuk sjellin dobi. Ndarja e kohëve të namazit dhe caktimi i tyre me precizitet flet për kujdesin e Islamit ndaj kohës e cila është vetë jeta e njeriut dhe materia e saj. Një ndarje precize e kohës së ditës dhe obligimet e saj prej adhurimeve, punëve tjera dhe pushimit. Obligimi i njeriut ndaj vetvetes me këtë rënditje është si obligimi i njeriut ndaj Allahut në kujdesin ndaj adhurimeve dhe organizimin e kohës.

Është më se e qartë për çdo të mençur se këto ligje dhe praktika morale në periudhën profetike kontribuan në ngritjen dhe konsolidimin e shoqërisë, prandaj besimtari e do atë që ka ligjësuar Allahu dhe i Dërguari i Tij, lavdia dhe paqja e Allahut qofshin mbi të!